



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Fotografi”

Ofruar nga Universiteti Arteve

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


Prof As Gjergji Islami

Dr. Sonia Jojiç

Dhjetor / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në “Fotografi”**

1	IAL aplikues:	Universiteti i Arteve
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Arteve te Aplikuara
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Fotografi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdheri MASR Nr. 236, date 19.07.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Niveli 6 (gjashtë)
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 Kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	-
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	17 PAE / 6 PAK
18	Numri i studentëve:	2021-2022 6 studentë; 2022-2023 7 studentë; 2023-2024 6 studentë.
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor në “Fotografi”, ofrohet nga Departamenti i Arteve të Aplikuara, pjesë e Fakultetit të Arteve të Bukura, në UA, duke përbajtur 180 kredite, me kohëzgjatje 3 vite akademike, me kohë të plotë në gjuhën shqipe. Programi i studimit Bachelor në “Fotografi” është program unik në natyrën specifike të tij në mbarë vendin. Ky program studimi vjen si qasje reflektuar dhe nga raste të ngjashme mbarë Europës e Shteteve të Bashkuara, ku programe të Arteve të Bukura, Fotografia është një nga zhanrat e cila ofrohet. Në këtë aspekt dhe për të lidhur më tepër dhe filozofinë e UA “studenti në qendër”, program i studimit shihet si ndërlidhës dhe të studentëve potencial nga shkollat e mesme artistike mbarë vendit por vecanërisht Liceun Artistik “Jordan Misja” për ti ofruar studentëve me fokus Fotografinë të kenë vazhdimësi dhe në programet universitare në të njëjtën fushë. Programi i studimit, ndërlidh stafin akademik me përvoj artistike mbreslënëse duke gërshetuar programin mësimorë me praktikën artistike të zhanrës së Fotografisë. Ky program shihet si “rregullator” në tregun e punës, për ti dhënë rëndësinë e duhur profesionit të fotografit, duke hulumtuar mbi mundësitë e ushtrimit të profesionit si artistë të lirë në zhanrën e fotografisë dhe artit pamorë ose duke e mbështetur këtë profesion në lidhje me institucione kulturore; kreative; apo private.

Për më tepër, stafi akademik përgjatë takimeve të kryera përgjate vizitës së GVJ, reflekton përkushtim në detyrat e caktuara për këtë program, si dhe investojnë kohë për të punuar më afër me studentët e programit. Përtej faktit se CV dhe aktiviteti artistik /kërkimorë i stafit akademik është vërtet mbreslënëse, ku shihet qartë si energji pozitive midis tyre për të rritur më tepër aktivitetin artistik të studentit nëpërmjet ekspozitave dhe projekteve në qendër bashkëpunimet me partnerë për zhvillimin më tej të profilit të fotografit në tregun e punës vendas dhe rajonal.

Duke qenë se programi i studimit është një program i ri, shihet me qendrim pozitiv dhe inkurajohet dhe aspekti i krijimit të mundësive të mëtejshme për angazhimin e stafit në programin e “Fotografisë” për projektet Erasmus+ si dhe për krijimin e mundësive në lidhje me mobilitete për studentët me profil Fotografinë.

Në raport me ambientet dhe bazën materiale ku ky program zhvillohet, inkurajohet aspekti i investimit për të rritur kapacitetet laboratorike si për fotografini analoge dhe për fotografinë dixhitale, si dhe për të parë mundësinë ku herë pas herë të shihet mundësia e riazhornimit të aparaturave, duke marrë në konsideratë konsumimin e tyre.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

ASCAL, bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Institucioni, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje: **Prof. As. Gjergj Islami** dhe **Dr. Sonia Jojiç**. Gjatë gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga koordinatorja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirneli.


Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Fotografi”, i ofruar nga Departamenti i Arteve të Aplikuara të Fakultetit të Arteve të Bukura pranë Universitetit të Arteve, filloi me prezantimin, si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga e-ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh, që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita në Universitetin e Arteve, u realizua në datën 20 dhe 21 Shkurt 2024, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara sipas agjendës së vizitës në IAL. Gjatë vizitës, në Universitetin e Arteve, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) zhvilloi takime me: Përgjegjësen e Departamentit dhe Dekanin, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, stafin akademik të programit të studimit, stafin e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë, Zyrën e Burimeve Njerëzore, përfaqësues të Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, si dhe me Sekretarinë mësimore.

GVJ zhvilloi gjithashtu intervista me studentët e programit, vizitoi Bibliotekën e Institucionit si dhe vëzhgoi mjediset e institucionit si: auditorë, laboratorë, shërbimet për studentët, etj. Gjatë takimeve të realizuara sipas agjendës, u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ekspertët kanë drejtuar pyetjet përkatëse. Pas vizitës në IAL, GVJ hartoi raportin e vlerësimit të jashtëm, bazuar në dokumentacionin në dispozicion nga dosja e vlerësimit të brendshëm, informacioni i depozituar në sistemin e informacionit të ASCAL, si dhe në informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitës të realizuar në Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin pranë ASCAL, si më poshtë vijon.

Universiteti i Arteve është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 31.10.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 50/10 Prot, datë 31.10.2024. Universiteti i Arteve njofton në ASCAL më datë 11.11.2024, nëpërmjet shkresës me nr. 1462/3, Prot, datë 07.11.2024, “*Kthim përgjigje mbi gjetjet rekomandimet e GVJ-së mbi Draft Raportin e programit të studimit Bachelor në “Fotografi”*”.

Ekspertët e vlerësimit u njohën me këto komente dhe japin argumentat si më poshtë:



1. Për komentin tek standarti II.1 kriteret. 3, 4 dhe konkluzione;

Ne lidhje me këto kritere, GVJ sqaron se plani mësimor është i ndërtuar përgjithësisht brenda veprimtarive formuese të kërkuara nga VKM 41/2018 dhe 185/2021. Sugjerohet te ri-konsiderohen veprimtaritë e kategorisë (A) “LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme” të cilat rezultojnë 10% kundrejt 15-20% të parashikuar nga VKM si dhe veprimtaritë e kategorisë (B) “LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën shkencore dhe artistike” të cilat rezultojnë 57% kundrejt 50-55% të parashikuar nga VKM.

Kjo mund të arrihet edhe pa cenuar përmbajtjen e programit, përmes zhvendosjes së njëres prej lëndëve “Teori e fushës” / “Teori e ngjyrës” / “Vëllim në hapësirë” nga kategoria B në kategorinë A, pasi nga përmbajtja ato mund të shihen edhe si lëndë metodologjike. Sikurse në S.II K.4 në lidhje me shpërndarjen e orëve në auditor dhe punën e pavarur nevojitet të specifikohen sipas tipologjisë së lendeve dhe ne rastin e lendeve atelie. **Raporti nuk pëson ndryshime**

2. Për komentin tek standarti II.1 kriteri. 5;

GVJ merr në konsideratë komentin e IAL-së, në lidhje me zhvillimin e konkursit të Fotografisë si dhe masat e sigurisë të përmendura nga GVB. **Raporti në këtë pikë pëson ndryshim**

3. Për komentin tek standarti II.1 kriteri. 7;

Ne lidhje me plotësimin e kodifikimit të programeve të studimit referuar VKM nr. 330 dt. 11.05.2022 "Për Specifikimet dhe Përmbajtjen e Kodifikimit të programeve të studimit të ofruara në UART", Universiteti i Arteve duhet të ndjekë udhëzimin e caktuar Pika 7, për të vijuar me propozimin argumentet lidhur me kodifikim e programit të studimit. **Raporti nuk pëson ndryshime.**

4. Për komentin tek standarti II.4 kriteri. 3;

Në lidhje e këtë koment, GVJ i qëndron mendimit të shprehur në raport, dhe sugjeron te ri-konsiderohet aspekti i përcaktimit të lëndëve me zgjedhje me profil të fotografisë apo dhe multimedias. **Raporti nuk pëson ndryshime.**

5. Për komentin tek standarti II.4 kriteri. 4;

Në lidhje me këtë koment është përmendur dhe më sipër ne standardin S.II.1 K3. *Plani mësimor është i ndërtuar përgjithësisht brenda veprimtarive formuese të kërkuara nga VKM 41/2018 dhe 185/2021. Sugjerohet te ri-konsiderohen veprimtaritë e kategorisë (A) “LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme” të cilat rezultojnë 10% kundrejt 15-20% të parashikuar nga VKM si dhe veprimtaritë e kategorisë (B) “LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën shkencore dhe artistike” të cilat rezultojnë 57% kundrejt 50-55% të parashikuar nga VKM. Raporti nuk pëson ndryshime.*

6. Për komentin tek standarti IV.2 kriteri.1;

Në lidhje e këtë koment, GVJ i qëndron mendimit të shprehur në raport, dhe sugjeron te ri-konsiderohet aspekti i vënies në dispozicion të sallave / laboratoreve të tjera për këtë program studimi. **Raporti nuk pëson ndryshime.**

7. Për komentet tek standartet VI.2 dhe VI.4 konkluzione;

Komenti i universitetit thekson se programi i studimit nuk ka ende Alumni. Ndërkohe, në RVJ theksohet nevoja për bashkëpunimin me Ekspertë të Jashtëm apo Alumni (në këtë rast të universitetit) apo përfaqësues të tregut të punës siç kërkohet në S VI.2 dh SVI.4, si dhe siç parashikon vetë institucioni në rastet e akreditimit për herë të parë: Duke iu referuar Rregullores së Funkcionimit të NJSBC, Neni 5, “përbërja e Komisionit është:

- Një specialist i SC në UART;
- Një përfaqësues për secilin Fakultet;
- Një përfaqësues i Studentëve;

Në rastet kur ka akreditime për herë të parë apo institucionale, thirret një ekspert i jashtëm. **Raporti nuk pëson ndryshime.**

8. Për komentin tek standarti IV.5 kriteri.2, Universiteti bie dakord me gjetjet e RVJ.

Raporti nuk pëson ndryshime.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Fotografi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë	Programi është hartuar në përputhje me interesat kombëtare si dhe me sfidat me të cilat përballlet Shqipëria. Universiteti i Arteve synon që të ofrojë fushe studimi të re per kontekstin e Shqiperise por jo per atë botërore; ku njohuritë klasike karakterizojnë një profesion të rëndësishëm dhe thelbësor në

<p>ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>nivel jo vetëm kombëtar, por edhe ndërkombëtar siç është fusha e artit të Fotografisë. Programi ka si për qëllim kryesor përgatitjen dhe thellimin e njohurive të ekspertëve në fushën e Fotografise duke bërë të mundur që të diplomuarit në këtë program të jenë të aftë t’i shërbejnë tregut të artit por dhe atë të dizajnit multimedial / visual por dhe të plotësojnë nevojat e tij në mënyrën më të mirë dhe më të kualifikuar.</p> <p>Tradita dhe eksperiencia kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e arteve pamore konsiderohet thelbësor në procesin e mësimdhënies në këtë program studimi e garantuar kjo, nga gërshetimi i mësimdhënies me staf akademik me profil artistik mbare kombëtarisht të njohur, shqiptarë e të huaj me përgatitje të lartë shkencore</p> <p><i>Evidencë. Nr.1.01 Statuti i UART,</i> <i>Evidencë. Nr.1.03 Rregullorja e ciklit të I të studimit,</i> <i>Evidencë. Nr.1.04. Rregullorja e Njësisë Kryesore FAB</i> <i>Evidencë. Nr.1.06. Rregullorja e Programit të studimit Bachelor në “Fotografi”</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor në Fotografi sipas pikës 2 të (PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE 2018-2025) është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit. Sipas objektivave të këtij program studimi veprimtaritë formuese synojnë formimin e ekspertëve vizual në programin e ciklit të parë Bsc 3 – vjeçar në Fotografi dhe krijimin e një alternative të re për të vazhduar studimet në fushën Multimediale Vizuale dhe Kulturore.</p> <p><i>Evidence. Nr 9. 1.0.7.VBA Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025.pdf</i> <i>Evidencë Tabela Nr. 9 - Plani mësimor dhe ngarkesa mësimore e Programit të studimit Bachelor në “Fotografi”</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Në përputhje me strategjinë e zhvillimit dhe si pjesë e objektivave të programit, UA ofron programin e studimit Bachelor “Fotografi” si një alternative te programeve të studimit Bachelor në FAB, duke ecur paralelisht në linjë me strategjinë e zhvillimit institucional duke plotësuar kështu më së miri gamën e ofruar nga Institucioni. Gjithashtu vlen të përmendet fakti se programi i studimit Bachelor “Fotografi” ka treguar një përkushtim të fortë ndaj cilësisë, kjo në përputhje me misionin dhe vlerat e institucionit që synojnë të nxisin ekselencën në mësimdhënie, si dhe ne diversitetin e programeve të arteve pamore në vend. Në këtë kuadër, ky</p>

	<p>program studimi i pajis studentët me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, dhe duke krijuar një bazë të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara në fushën e fotografisë dhe arteve pamore.</p> <p><i>Evidencë Nr.1.07 Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025”</i></p>																		
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Pertej aktivitetit mbi 60 vjet Fakulteti i Arteve të Bukura, ka përvojën dhe kapacitetet e nevojshme për ofrimin e programeve të studimit, pra ka kapacitetet e duhura në fushën akademike për të ofruar këtë program studimi. Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Arteve të Bukura, i cili ka në përbërje tre njësi bazë:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Departamenti i Arteve të Aplikuara; – Departamenti i Pikturës; – Departamenti i Skulpturës; <p>Stafi akademik bazuar në CV-të rezultoi, se është mjaft i kualifikuar në fushën artistike dhe kerkimore, si dhe baza materiale për të zhvilluar realizimin të këtij programi studimi është mjaft e mirë. Stafi akademik i Fakultetit të Arteve të Bukura është në përputhje me kriteret ligjore për sa i përket titujve dhe gradave të tyre, dhe me experience mjaft mbreselënëse në fushën artistiko – akademike.</p> <p>Personeli Akademik Efektiv (PAE) dhe ai me kontratë (PAK) i angazhuar në këtë program studimi, në vitin akademik 2023-2024 kanë kualifikimet si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="590 1299 1356 1657"> <thead> <tr> <th>Kualifikimi</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr.</td> <td>2</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>2</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Dr./PhD</td> <td>6</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>7</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>17</td> <td>6</td> </tr> </tbody> </table> <p>Ndër të dhënat e tabelave në lidhje me programin e studimit dhe stafin, shihet qartë se që nga hapja e programit janë afruar staf akademik (As. Lektor) si PAE; Evidence Tabela 2, viti i programit 2012-2022 si dhe 2022-2023 dhe 2023-2024, duke rritur kapacitetet për të zhvilluar një program solid në fushën artistike dhe zhanres së Fotografisë.</p>	Kualifikimi	PAE	PAK	Prof. Dr.	2	0	Prof. Asoc.	2	1	Dr./PhD	6	1	Msc.	7	4	Total	17	6
Kualifikimi	PAE	PAK																	
Prof. Dr.	2	0																	
Prof. Asoc.	2	1																	
Dr./PhD	6	1																	
Msc.	7	4																	
Total	17	6																	

	<p>Në Departamentin e Arteve te Aplikuara, i cili është përgjegjës për programin e studimit, (18 staf akademik efektiv dhe 6 staf akademik me kontratë), të cilët zotërojnë kualifikimin si më poshtë:</p> <table border="1" data-bbox="587 336 1362 685"> <thead> <tr> <th>Kualifikimi</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Prof. Dr.</td> <td>2</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Prof. Asoc.</td> <td>2</td> <td>0</td> </tr> <tr> <td>Dr./PhD</td> <td>1</td> <td>2</td> </tr> <tr> <td>Msc.</td> <td>13</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Total</td> <td>18</td> <td>6</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Evidencë Tabela Nr. 2 sipas modelit të tabelave të ASCAL, Stafit akademik i Departamenteve të FAB për vitet 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024 per programin Bachelor në "Fotografi"</i></p>	Kualifikimi	PAE	PAK	Prof. Dr.	2	0	Prof. Asoc.	2	0	Dr./PhD	1	2	Msc.	13	4	Total	18	6
Kualifikimi	PAE	PAK																	
Prof. Dr.	2	0																	
Prof. Asoc.	2	0																	
Dr./PhD	1	2																	
Msc.	13	4																	
Total	18	6																	
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>GVJ konstatoi që fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në "Fotografi" është në përputhje me fushën kërkimore-shkencore dhe akademike të Fakultetit të Arteve të Bukura, si dhe atë të njësisë bazë, të Departamentit të Arteve te Aplikuara.</p> <p>Programi i studimit ofrohet në përputhje me Ligjin e arsimit të lartë nr. 80, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri", sipas VKM nr. 41 datë 24. 01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë", sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>																		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se UA ofron programe studimi në përputhje me interesat kombëtare dhe synon të ruaje vlerat akademike kulturore kombëtare.</i></p> <p><i>Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, që është të krijojë, zhvillojë dhe përcjellë dije përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, të formojë specialist të lartë.</i></p> <p><i>Cdo Universitet i Fokusuar në Arte Pamore, "Fotografia" si program studimi mbështet dhe përmbush spektrin e studimeve në fushën e artit, si dhe jep mundësinë për tu zhvilluar bazat në programet e tjera pamore apo multimediale.</i></p>																		

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Në kuadër të statusit dhe trajtim të veçantë, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në zbatim të VKM Nr. 145, datë 10.03.2021 “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”, pergjatë vizitës në UART dhe takimeve me stafin si dhe sipas Evidences 1.0.8 dhe 2.0.3, në fillim të çdo viti akademik njësitë kryesore zhvillojnë takime mbi ngarkesës së stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, caktimi i detyrave të personelit ndihmës akademik si dhe personelit administrative, si dhe diskutime mbi ekspozita artistike në fushat e mbuluara nga UART në përputhje me programet mesimore.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 1.0.5 Rregullore e Departamentit të Arteve të Aplikuara.</i></p> <p><i>Evidencë. Nr.1.08 Raporti vjetor i Departamentit të Arteve të Aplikuara</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>UA nëpërmjet dhe historiku të tij me impaktit të gjere per fushën e artit, vazhdon të zhvilloj marrëdhënie bashkëpunimi në fushën e edukimit dhe kërkimit artistik/shkencor me shumë Universitete dhe Institucione në Europë, nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe duke shërbyer si instrumente të politikës institucionale në mbështetje të veprimtarisë së krijuese artistike dhe kërkimit artistik/shkencor.</p> <p>Në evidencat e vena në dispozicion nga UA shihet qartë se profili i studimit “Fotografi” në lidhje me marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet lidhet me se mire mendimi i studimit me hapësirën e kerkuar per nje profil studimi dhe profil per ekspert në fotografi. Lista si me poshtë:</p> <p>- Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë;</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Conservatoire nacional supérieur de musique et de danse de Paris; - Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë së Republikës së Shqipërisë, - Agjencisë Italiane të Bashkëpunimit për Zhvillim; - Marrëveshje Mirëkuptimi ndërmjet UART dhe Festivalit të Filmit në Shkup CINEDAYS; - Memorandum Mirëkuptimi midis Zhejiang Normal University in Jinhua, Zhejiang, Kinë; - Protokoll i Bashkëpunimit të Universitetit të Arteve të Bukura “Mimar Sinan” dhe Universitetit të Arteve, Universitetin ‘Aleksandër Moisiu’ Durrës; Universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkodër; Shkollën kombëtare artistike “Jordan Misja” (Referoju Evidencës Standardi I,1, Kriteri 4) <p>Referuar RVB, Universiteti i Arteve i jep një rëndësi të veçantë pjesëmarrjes në bashkëpunime ndërkombëtare, që mundësojnë mobilitetin e studentëve për të gjitha ciklet e studimeve, si dhe stafit akademik me kohë të plotë. UART ka marrë pjesë rregullisht në programin e mëhershëm Tempus. Vitet e fundit ka disa marrëveshje partneriteti në kuadër të projektit Erasmus+ mbështetur financiarisht nga BE.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 1.09 UART në marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të projektit Erasmus dhe Erasmus +.</i></p> <p><i>Evidencë . Nr. 1.10 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të FAB me Institucione të tjera të Arsimit të Lartë.</i></p> <p><i>Evidencë Nr.1.11 Marrëveshje Bashkëpunimi të UART me institucione të tjera.</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Për realizimin e praktikave mësimore sidomos në fushën e arteve aplikative është shumë e rëndësishme për studentin të zhvillojnë nderveprim me institucione të cilat do të mirepresin specialist të fushes së Fotografisë; aktualisht programi Bachelor në “Fotografi” ka zhvilluar marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe si ato të Ministrisë së Kulturës, Pakti me Universitetin, specifikisht me Galerinë Kombëtare të Arteve dhe Qendrën Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore.</p> <p>Gjatë takimit të GVJ, është theksuar gjithashtu rëndësia e zgjerimit dhe vazhdimet të këtyre bashkëpunimeve me këto instanca e të tjera të cilat do të vijojnë. Theksohet se për momentin ku është zhvilluar dhe takimi me grupin e GVJ praktikat e para mësimore janë zhvilluar brenda strukturave të</p>

	<p>Fakultetit, në Galerinë FAB, në udhëtime didaktike dhe workshope të organizuara nga stafi.</p> <p><i>Evidencë . Nr. 1.10 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të FAB me Institucione të tjera të Arsimit të Lartë.</i></p> <p><i>Evidencë Nr.1.11 Marrëveshje Bashkëpunimi të UART me institucione të tjera.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Referuar RVB, Departamenti i Arteve të Aplikuara, në bashkëpunim edhe me Dekanatin e Fakultetit të Arteve të Bukura, ka zhvilluar marrëveshje bashkëpunimi në funksion të realizimit të programit të studimit dhe të objektivave të këtij programi studimi.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 1.11 Raport mbi marrëveshjet e bashkëpunimit në tërësi të UART</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UA për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda dhe jashtë institucionit.</i></p> <p><i>UA vazhdon të zhvilloj marrëdhënie bashkëpunimi në fushën e edukimit dhe kërkimit artistik/shkencor me shumë Universitete dhe Institucione në Europë, nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe, ndërsa për realizimin e praktikave mësimore sidomos në fushën e arteve aplikative UA ka krijuar marrëveshje bashkëpunimi me institucionet homologe per programin Bachelor në "Fotografi".</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1

Adresa: "Bruga e Durrësit"
Pranë gjimn. «Q. Stafa», Tiranë

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Në lidhje me programin e studimit Bachelor në “Fotografi” UA siguron korrektësi në hartimin e tij, si dhe specifikën e këtij programi, ku përtej aspektit kërkues nga tregu i punës për profesionist dhe artist, ndërvepron si rregullator për të njohur këtë fushë studimi në Shqipëri, duke e sjellë atë në të njëjtat trajta ku Universitete të tjera të Artit Pamor apo Arteve Klasike e sjellin “Fotografinë” si program studimorë.</p> <p>Programi i studimi Bachelor në “Fotografi” është në përputhje me udhëzimet e MAS, dhe me legjislacionin vendas në fuqi, duke zbatuar dhe ndjekur Sistemin Europian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve, përkuar me fushën 6 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve</p> <p>Programi i studimit organizohet dhe zgjat tre vite studimi dhe me 180 ECTS në total. Në planin mësimor sipas Veprimtarive Formuese lëndët janë paraqitur të ndara sipas tipit të veprimtarisë, në lëndë bazë, karakterizuese, lëndë ndërdisiplimore, plotësuese dhe detyrime përmblyëse, në përputhje me VKM nr. 41 datë 24. 01.2018 ndryshuar me VKM nr 879/2019 dhe VKM nr.185/2021.</p> <p><i>Evidencë Tabela Nr. 9 sipas modelit të tabelave të ASCAL - Plani mësimor dhe ngarkesa mësimore e Programit të studimit Bachelor në “Fotografi”</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Fotografi” është hartuar për t’iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës, të cilat tashmë i nevoiten tregut aktual dhe larmshmërisë së programeve studimore në vend. Përtej njohurive artistike të cilat janë baza për studentët të cilët njihen me një program të tillë duke zhvilluar të kuptuarin kritik të teorisë; konceptet e njohuritë të përparuara me shprehi praktike janë pjesë e këtij programi studimorë. Programi Bachelor në “Fotografi” përtej pjesës teorike historike dhe artistike ku studenti njihet, e lejon studentin të diplomuar në këtë program të ndjekë dy trajta;</p> <ul style="list-style-type: none"> - atë të fotografisë artistike apo aspektin e fotografisë komerciale. Vecantia e këtij programi është në vetë mediumin e “Fotografisë”, medium i cili ndërlidh artin personal krijues; me shkencën e fotografisë me televizionin;

<p>problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>- aspektet multimediale të tij, duke nxitur kështu dhe synimet individuale të studentit;</p> <p>Duke pasur një histori mjaft të qëndrueshme të “Fotografisë” me arkivin dhe muzeun “Marubi”, Shkodër; apo “Gjon Mili” Korçë <i>shihet mëse e nevojshme që ky program të vendos bazën për zhvillimin më tej të mediumit të fotografisë në vend si pjesë e trashëgimisë kulturore.</i></p> <p>Në respekt të kërtimeve individuale të studentëve, ky program është një nxitës dhe inkurajon studentët të bëjnë zgjedhjet e tyre për mënyrën e aplikimit të detyrave dhe temave të dhëna, për të praktikuar teknikën si dhe për të zgjeruar dhe thelluar konceptin artistik.</p> <p><i>Evidencë. Nr. 1.06 Rregullorja e programit Bsc në “Fotografi”</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Në VKM nr. 41, datë 24. 01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë” ndryshuar me VKM nr 879/2019 dhe VKM nr.185/2021 në tabelën nr 1 në Shtojcë janë përcaktuar elementët e programeve të studimit. Veprimtaritë formuese në programin e studimit Bachelor në Fotografi, grupohen si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kategoria A - Lëndë bazë - përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme – 15 deri në 20% të krediteve Rezulton 10 %; • Kategoria B - Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore – 50 deri në 55 % të krediteve Rezulton 57 %; • Kategoria C - Lëndë ndërdisiplinore/Integruese – nën disiplina, profile dhe grup lëndë me zgjedhje – 12 deri në 15 % të krediteve Rezulton 14 %; • Kategoria D - Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale – 10 deri në 15% të krediteve Rezulton 14 %; • Kategoria E - Detyrime përmbyllëse – 3 deri në 5 % të krediteve Rezulton 14 %; <p>Nga sa më sipër Shihet se shperndarja nëpermjet lendeve të kategorise A nga 15% - 20% rezulton vetëm me 10 % dhe per lendet e kategorise B është 57 % nga 50%- 55%.</p> <p><i>GVJ sugjeron, që është e nevojshme një rishikim per ketegoritë e përcaktuara për të pasur një shperndarje në përputhje me aktet ligjore.</i></p>

	<p><i>Evidencë Tabela Nr. 9 sipas modelit të tabelave të ASCAL - Plani mësimor dhe ngarkesa mësimore e Programit të studimit Bachelor në "Fotografi"</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 1.06 Rregullorja e programit Bsc në "Fotografi", Neni 4</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Fotografi" ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale 10 ECTS pjese e lëndëve të kategorisë D ku totali është dhe të detyrimeve përmbyllëse është 26 ECTS 14 %. Më konkretisht, në këtë program studenti merr kreditet si me poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 18 kredite – 10 % për lëndët e kategorinë A, - 103 kredite – 57 % kredite për lëndët e kategorisë B, - 26 kredite – 14 % kredite për lëndët e kategorisë C, - 26 kredite - 14 % kredite për lëndët e kategorisë D - 7 kredite – 3.8 % kredite për detyrimin përmbyllës që është kategoria E, e cila është diploma. <p>Kjo shpërndarje duhet realizuar sipas VKM 41, dt., 24.01.2018, për kategorinë e ciklit të parë "Bachelor" ku përqindja totale e lëndëve të kategorive A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 70% në rastin e programeve "Bachelor" ose të kontrollohen tabelat të cilat i bashkangjithen raportit.</p> <p><i>GVJ rekomandon, që të shfaqen kreditet përmbyllëse të orëve në auditor apo individuale tek plani mesimorë në rastin e Projekt Diplomës. Ndërkohë në Planin Mësimorë (Tabela 10 në RVB); rezulton se praktika profesionale është 6 Kredite ndërsa në (Tabelën 9 shfaqen 10 Kredite). Në shumatoren përfundimtare rezulton se janë orë 1938 të pa argumenta në shpërndarjen e tyre si, studio; laboratore apo projekt kursi.</i></p> <p><i>Evidencë Tabela Nr. 9 RVB - Plani mësimor dhe ngarkesa mësimore e Programit të studimit Bachelor në "Fotografi".RVB</i></p> <p><i>Evidencë Tabela Nr. 10 RVB - Plani mësimor i Programit të studimit Bachelor në "Fotografi".RVB</i></p> <p><i>Evidence. 1.0.0 Raporti i Vlerësimit të Brendshëm të programit të studimit Bsc. në Fotografi (referuar tekstit te Standarti II. Kriteri 4 ne lidhje me shperndarjen e krediteve)</i></p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe</p>	<p>UA zhvillon një program mjet të vecantë dhe me impact per tregun e punës në fushën e studimit të Arteve Pamore nëpërmjet programit Bachelor në "Fotografi", Universiteti i Arteve ofron</p>

<p>financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>programe studimi në përputhje me misionin dhe objektivat institucionale duke krijuar të gjitha mundësitë që programet e ofruara të zbatohen në përputhje me standardet kombëtare dhe me përvojat më të mira europiane. Në lidhje me, procedurën për pranimin e dokumentacionit, për secilin aplikues sipas kategorive shpall kriteret për pranim dhe kriteret mbi konkurset të zhvilluara nga UA. Gjitashtu Universiteti i Arteve ndjek një politikë mbështetëse për studentët me aftësi ndryshe. Për këtë kategori, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, parashikohen kriteret për përfitimin e bursave në bazë të kategorive përkatëse, të cilat ndryshojnë çdo vit akademik</p> <p>Në UA pranimi i studentëve kryhet nëpërmjet konkursit të pranimit, kriteret e të cilave hartohen nga Departamentet dhe miratohen në Senatin Akademik <i>Evidencë Nr 5.02 Rregullorja për zhvillimin e konkursit për vitin akademik 2022-2023 dhe kriteret e miratuara me vendim Senati të dy cikleve të studimit. (fq.17-19 per programin e Bachelor Fotografi).</i></p> <p><i>Evidence. Nr. 5.0.2 VSA nr 10 dt 02.02.2020 për miratimin e rregulloreve dhe kriterëve të konkurseve të pranimit për vitin akademik 2022-2023 për FAB.</i></p> <p><i>Evidence. Nr. 5.0.3 VSA Nr. 17 dt 10.03.2022 për deklarimin e kuotave të pranimit për ciklin e parë 2022-2023 në FAB.</i></p> <p><i>Evidence. Nr.5.0.4 VSA Nr 17, Dt 10.03.2022 Për deklarimin e kuotave të pranimit për vitin akademik 2022-2023 në UART/</i></p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>UA, është i vetmi Institucion i cili ofron program të Ciklit të parë në Fotografi. Program specifik në profilin Bachelor në “Fotografi” është i vetmi por ka profile studimi të ciklit të parë Bachelor në Arte dhe Dizajn brenda vendit të cilat përmbajnë një ngjashmëri me lëndët të cilat ofron ky program.</p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p><u>Sygjerohet</u> të zhvillohet plotësimi i kodifikimit të programeve të studimit referuar VKM nr. 330 dt. 11.05.2022 “Për Specifikimet dhe Përmbajtjen e Kodifikimit të programeve të studimit të ofruara në UART” përtej faktit që në dokumentat e vëna në dispozicion rezulton vetëm VKM nr. 330. Evidenca 2.0.2</p>

<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Ky kriter nuk zbatohet në këtë program studimi</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në lidhje me programin studimor Bachelor në "Fotografi" UA siguron korrektësi në hartimin e tij, si dhe specifikën e këtij programi, ku përtej aspektit kërkues nga tregu i punës për profesionist dhe artist, ndërvepron si rregullator për të njohur këtë fushë studimi në Shqipëri, duke e sjellë atë në të njëjtat trajta ku Universitete të tjera të Artit Pamor apo Arteve Klasike e sjellin "Fotografinë" si program studimorë.</i></p> <p><i>Programi i studimit Bachelor në "Fotografi" është hartuar për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës, të cilat tashmë i nevoitet tregut aktual dhe larmishmërisë së programeve studimore në vend.</i></p> <p><i>Përtej njohurive artistike të cilat janë baza për student të cilët njihen me një program të tillë duke zhvilluar të kuptuarin kritik të teorisë; konceptet e njohuritë të përparuara me shprehi praktike janë pjesë e këtij programi studimorë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike</p>	<p>UA ka zhvilluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit periodik. Ky vlerësim është finalizuar nga Bordi i Akreditimit në ASCAL me Vendim BA Nr.17, datë 24.03.2022 që akrediton në formë institucionale me vlefshmëri 6 vite, për periudhën nga 24/03/2022 deri në 23/03/2028.</p> <p>Fakulteti i Arteve të Bukura si njësi kryesore përgjegjëse për këtë program studimi, ka në përbërje 3 njësi bazë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Departamenti i Arteve të Aplikuara; • Departamenti i Pikturës;

vlerësimin dhe akreditimin.

• Departamenti i Skulpturës;

Fakulteti i Arteve të Bukura, ka në përbërjen e tij, 41 personel akademik efektiv (PAE) në vitin akademik 20223-2024, i ndarë në tre njësi bazë, si:

Njësia bazë	Nr. PAE	Tituj/Grada
Departamenti i Arteve të Aplikuara	18	2 – Prof. Dr. 2– Prof. Asoc. 1 – Dr. 13 - Msc
Departamenti i Pikturës	16	2 – Prof. Dr. 1 – Prof. Asoc. 5 – Dr. 8 - Msc
Departamenti i Skulpturës	7	1 – Prof. Dr. 2 – Prof. Asoc. 4- Msc
Total	41	41

Gjithashtu Fakulteti i Arteve të Bukura ka edhe 16 PAK, dhe 9 Staff Ndhimes Akademik.

Çdo njësi bazë është i përbërë nga të paktën 7 staf akademik, ku të paktën 3 prej tyre janë me gradë shkencore. Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, Departamenti i Arteve të Aplikuara, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë për vitet akademike:

Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	2	-	2	-	2	-
Prof. Asoc.	2	-	2	-	2	-
Dr./PhD.	1	2	1	2	1	2
Msc.	9	4	11	4	13	4
Totali	14	6	16	6	18	6

	<p><i>Evidencë Tabela Nr. 1 sipas modelit të tabelave të ASCAL - Nr. i personelit akademik për çdo njësi bazë</i></p> <p><i>Evidencë Ligji për Arsimin e Lartë Nr. 80/2015</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 1.01 Statuti i UART</i></p> <p><i>Evidencë Tabela Nr. 2 sipas modelit të tabelave të ASCAL - Mbi numrin e pedagogëve me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme dhe e kualifikimit të tyre.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Referuar RVB dhe Aneks, Tabelat Përmbledhëse, merret informacioni që UA ka të punësuar 9 personel ndihmës-akademik në rang Fakulteti.</p> <p>Për mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies, projekteve artistike dhe/ose të kërkimit shkencor, caktohet personeli ndihmës akademik me karakter mësimor artistik/shkencor, duke qenë pjesë e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit.</p> <p>Personeli ndihmës akademik me karakter administrativ ndihmon në realizimin dhe mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies, artistike dhe/ose të kërkimit shkencor dhe/ose të zhvillimit të UART në nivel njësie bazë, njësie kryesore ose në nivel institucional.</p> <p><i>Evidencen Nr. 1.0.2 Rregullore e UART Neni nr. 29</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 1.04 Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore e Fakultetit të Arteve të Bukura Neni nr.17.</i></p> <p><i>Evidencë. Nr. 1.01 Statuti i UART neni nr. 69, 70.</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në</p>	<p>Në Rregulloren e FAB, përgjegjësit e grupeve mësimore janë përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin programit në përputhje me objektivat e tij. Në rastin e Programin e studimit Bachelor në “Fotografi” është caktuar Prof.Asc. A. F.(<i>Evidence. Nr. 2.0.3</i>) në rolin e koordinatorit të programit të studimit, kjo e theksuar dhe gjatë vizitës së GVJ në institucion. Grupet mesimore- artistike – kerkimore brenda departamenteve apo midis tyre është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>

përputhje me objektivat e tij.	<p>Evidence. Nr. 1.0.5 Rregullore e Departamentit të Arteve të Aplikuara..pdf Neni nr. 9</p> <p>Evidence. Nr. 1.0.4 Rregullore e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore të Fakultetit të Arteve të Bukura..pdf Neni nr.15, 16</p> <p>Evidence. Nr. 2.0.3 Procesverbal i një mbledhjeje të Departamentit..pdf</p>			
Konkluzione	<p><i>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</i></p> <p><i>Funksionet e Fakultetit dhe Departamenteve janë të përcaktuara në Statutin e Universitetit të Arteve. Për mbështetjen e veprimtarive të mësimdhënies, projekteve artistike dhe/ose të kërkimit shkencor, caktohet personeli ndihmës akademik me karakter mësimor artistik/shkencor, duke qenë pjesë e njësisë bazë dhe shërben për mbështetjen e veprimtarive të kësaj të fundit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	<p>Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. Dokumentat e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor janë të plota. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit disponon Rregulloren e Universitetit, Rregulloren e Fakultetit të Arteve të Bukura, Rregulloren e Programit të studimit, Rregulloren e Departamentit të Arteve të Aplikuara, Planin mësimor, kurrikulën e programit të studimit, syllabuset e lëndeve, etj.</p> <p>Programi mësimor i lëndës/syllabusi hartohet për çdo disiplinë që përmban plani mësimor sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe VKM Nr. 145, datë 10.03.2021. Pjese</p>

	<p>e programit të studimit janë dhe syllabuset. Syllabuset pertëj zbatimit të programit i cili hartohet nga pedagogu perkatës, funksionojnë për të rakorduar dhe mbi mos perseritjen e tamatikave të njëjta.</p> <p>Evidencë 1.0.3 Rregullore e Ciklit të parë të studimeve Bachelor</p> <p>Evidencë. Nr. 1.06 Rregullore e Prog. Stud. Neni 1- 8</p> <p>Evidencë 1.0.5 Rregullore e Departamentit të Arteve të Aplikuara</p> <p>Evidencë 1.0.4 Rregullore e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore të Fakultetit të Arteve të Bukura</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në Fotografi organizohet me jo më pak se 180 kredite europiane (ECTS) me kohëzgjatje tre vjecare.</p> <p>Viti akademik organizohet në semestra, sezone provimesh, module/sezon vere. Viti akademik përmban 2 semestra me kohëzgjatje 15-16 javë. Plani mësimor përmban informacionin në lidhje me orët që zhvillohen brenda dhe jashtë auditorit si dhe detyrimet për çdo lëndë. Ngarkesa totale vjetore për programin është 4170 orë, nga të cilat 2085 orë në auditor dhe 2085 orë punë individuale.</p> <p>Programi i studimit Bachelor në “Fotografi” zhvillohet me kohë të plotë duke u organizuar në lëndë, ndarë në semestra perkatës të ndara në 3 vite akademike dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me VKM nr. 41, dt. 24.1 2018, udhëzimet e MAS, legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit European të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve.</p> <p>Evidencë VKM Nr. 41, Dt. 24.01.2018,</p> <p>Evidencë Tabela Nr. 9 sipas modelit të tabelave të ASCAL - Plani mësimor dhe ngarkesa mësimore e Programit të studimit Bachelor në “Fotografi</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Fotografi” përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike në lidhje me pranimet duke i respektuar ato, transferimet apo ekuivalentimit të studimeve.</p>

<p>specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në <i>nenet 29 dhe 30</i> të Rregullores së Fakultetit të Arteve të bukura, jepen procedurat dhe kriteret e pranimit në Programet e studimeve. Në <i>nenin 28</i> në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Fotografi, jepen kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në UA kandidatët për student i nënshtrohen konkurseve të pranimit për të gjitha programet; - Konkursi organizohet në zbatim të kriterëve të miratuara nga Senati Akademik; - Cdo person që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm ka të drejtë të konkurojë; - Konkursi për seleksionimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve të rinj zhvillohet sipas kriterëve teknike si më poshtë; <ul style="list-style-type: none"> a. Punë proktike (fotografi) b. Testim teorik c. prezantim i dosjes personale (fotografi) <p>Evidencë. Nr. 1.01. Statuti i UART neni 90, 91 92, 93, 114</p> <p>Evidencë. Nr. 1.06 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në “Fotografi”</p> <p>Evidencë 1.0.4 Rregullore e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore të Fakultetit të Arteve të Bukura</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Në lidhje me programin e studimit të Bachelor në “Fotografi” informacioni në lidhje me lëndet pasqyrohet nëpërmjet Planit Mësimor të Programit të Studimit. Koordinatorët të caktuar sipas profilit të programit mbikqyrin praktikave mësimore, të cilët ndjekin realizimin me sukses të procesit të zhvillimit të tyre.</p> <p>Në çdo plan mësimor të programit Bachelor në “Fotografi” si dhe në secilin syllabus paraqiten informacionët e nevojshme për seminarët apo orët e laboratorit, duke plotësuar të gjithë përbërësit formues të programit brenda dhe jashtë auditorit. Syllabuset rishikohen dhe miratohen përpara fillimit të vitit akademik nga përgjegjësi i departamentit dhe hartohen në përputhje me udhëzimet përkatëse.</p> <p>Evidencë Tabela Nr. 9 sipas modelit të tabelave të ASCAL - Plani mësimor dhe ngarkesa mësimore e Programit të studimit Bachelor në “Fotografi”</p>

	Evidence. Nr. 2.0.3 Procesverbal i një mbledhjeje të Departamentit..pdf
<p>Kritëri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Përgjatë takimeve në institucion GVJ u informua se programet e lëndëve të programit të studimit Bachelor në “Fotografi” do të jenë në përmirësim të vazhdueshëm duke marrë në konsideratë se programi i studimit është i ri dhe akoma nuk ka nxjerrë diplomantët 2023-2024.</p> <p>Duket qartë se për programin e caktuar nga viti i tij i hapjes janë afruar pedagogë të brendshëm me specializim të studimeve të tyre në fushën e Fotografisë. Përgjatë takimeve, u theksua gjithashtu se ka ripërditësim mbi literaturën e zgjedhur, ku kontribut kanë dhe botimet më të fundit në fushën e Fotografisë në gjuhën Shqipe nga Dr. Ermir Hoxha “Historia e Fotografisë Shqipëtare”. Në lidhje me ndryshime në planin mësimorë të programit të studimit ato do të zhvillohen nëse do të realizohen nëpërmjet Vendim të Senatit Akademik të IAL. Gjithashtu përgjatë takimit të zhvilluar u theksua dhe <i>dëshira dhe nevoja për të hartuar dhe vënë në fuqi dhe program 2 vjeçar Master në Fotografi për ti ofruar një specializim të vazhdueshëm kërkimorë artistik për studentët e këtij profili.</i></p> <p>Evidencë VKM Nr.185, datë 25.03.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 41 datë 24.01.2018” shkronja c e pikës 2.9</p> <p>Evidencë. Nr.1.06 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në “Fotografi”</p> <p>Evidencë. Nr. 2.03 Procesverbal i një mbledhjeje Departamenti</p> <p>Evidencë Tabela Nr. 2 sipas modelit të tabelave të ASCAL - Stafi akademik me emra sipas departamentit</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programet e studimit të cilat zhvillohen në Departamentin e Arteve të Aplikuara, pjese e FAB, disiplinohet sipas rregullores përkatëse të studimeve të ciklit të parë në rastin e programit Bachelor në “Fotografi” apo per programet e tjera brenda FAB të cilat ofrojnë dhe ciklin e dytë, mbi të cilat janë mbështetur edhe rregulloret e programeve të studimit. Programi i studimit Bachelor në “Fotografi” përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët në lidhjen me kriteret e përgjithshme dhe specifike në lidhje me pranimet duke i respektuar ato, transferimet apo ekuivalentimit të studimeve. Për programin e studimit janë ofruar pedagogë të brendshëm me specializim të studimeve të tyre në fushën e Fotografisë. përgjatë takimit të zhvilluar u theksua dhe dëshira dhe nevoja për të hartuar dhe vënë në fuqi dhe program 2 vjeçar Master</i></p>

	<i>në Fotografi për ti ofruar një specializim të vazhdueshëm kërkimorë artistik për studentët e këtij profili.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimët të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Programi i studimit është i hartuar me lëndë të cilat janë esenciale për marrjen e njohurive në fushën e fotografisë. Emërtimi i programit të studimit tregon kompetencat që përfitojnë studentët që diplomohen në këtë program studimi. Emërtimi i lëndëve është në përshtatje me përmbajtjen e tyre.</p> <p>Emërtimi i programit të studimit Fotografi, përmbajtja e veprimtarive formuese të këtij programi, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundeson dhe aftësimin dhe pajisjen e tyre me njohuri praktike të kërkuara në tregun e punës. Gjithashtu, sipas semestrave në planin mësimor shihet qartë se program ofron hapësirën për të vijuar me studime të mëtejshme në ciklin e dytë të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve që mbarojnë këtë program studimi në Institucione, organizata, qëndra punë apo biznesi të cilët kanë nevojë për fotografimin e tyre duke ju besuar atyre imazhin. Në profilin e arteve pamore ku bën pjesë dhe zhanra e studimit të Fotografisë, puna individuale dhe praktika është mëse e rëndësishme, gjë që i ndihmon studentët të jenë të aftë për t'i përdorur këto aftësi edhe në të ardhmen.</p> <p>Evidencë Shtojca 1 e VKM 41 datë 24.01.2018</p> <p>Evidencë Tabela Nr. 9 sipas modelit të tabelave të ASCAL - Plani mësimor dhe ngarkesa mësimore e Programit të studimit Bachelor në "Fotografi"</p> <p>Evidencë Nr. 2.04 Analizë e Tregut të Punës</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në</p>	<p>Në programin e studimit Bachelor në "Fotografi", lëndët/modulet të cilat ofrohen japin bazën për një program bachelor në fotografi, ku studenti është i aftë për të hyrë në tregun e punës. Gjithashtu përtej aspektit praktik ata formohen</p>

<p>kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>dhe në aspektin teorik të cilet behen me të aftë për të vijuar me studime në program Master apo për të vijuar punën në aspektin personal artistik. Kjo ndarje në dy kategori shihet dhe në ndarjen e lendeve LËNDË BAZË - LËNDË KARAKTERIZUESE.</p> <p>Evidencë. Nr. 1.06 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në “Fotografi”, neni 2</p> <p>Evidencë Nr. 2.04 Analizë e Tregut të Punës</p> <p>Evidencë Tabela Nr. 10 sipas modelit të tabelave të ASCAL</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Në strukturën e programit të Bachelor në “Fotografi” lëndë si: Fotografi, Fotografi analoge, Fotografi digjitale, Projekt portfolio, Forme, Histori fotografie, janë lëndë të cilat janë themeli i çdo programi studimor në zhanrin e fotografisë me programe të ngjashme ndërkombëtare. Duke qënë se është një program studimi 180 kredite vihet re se shpërndarja e lëndëve në të tre vitet akademike dhe semestrat e tyre përkatës është e balancuar dhe zhvillon marrjen e dijeve në mënyrë graduale, ku dhe studenti është në gjëndje ku përgjatë dy viteve të fundit akademike të këtë përfutur bazën e programit dhe të gjetashtu ka lirshmërin për të vijuar në zhvillimin e aspektit artistik individual.</p> <p><i>Duke qënë se nuk ka profil të studimeve Master në fotografi të ofruar në UA, <u>GVJ sygjeron</u> të ofrohen lëndë me zgjedhje në profilin e fotografisë apo dhe multimedias.</i></p> <p>Evidencë Tabela Nr. 9 sipas modelit të tabelave të ASCAL - Plani mësimor dhe ngarkesa mësimore e Programit të studimit Bachelor në “Fotografi”</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Veprimtaritë formuese në programin e studimit Bachelor në Fotografi, grupohen si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kategoria A - Lëndë bazë - përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme – 15 deri në 20% të krediteve Rezulton 10 %; • Kategoria B - Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore – 50 deri në 55 % të krediteve Rezulton 57 %; • Kategoria C - Lëndë ndërdisiplinore/Integruese – nën disiplina, profile dhe grup lëndë me zgjedhje – 12 deri në 15 % të krediteve Rezulton 14 %;

- **Kategoria D - Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale – 10 deri në 15% të krediteve Rezulton 14 %;**
- **Kategoria E - Detyrime përmbyllëse – 3 deri në 5 % të krediteve Rezulton 14 %;**

Nga sa më sipër Shihet se shperndarja nëpermjet lendeve të kategorise A nga 15% - 20% rezulton vetëm me 10 % dhe per lendet e kategorise B është 57 % nga 50%- 55%.

Pertej faktit se lendet të cilat ofrohen janë baza e çdo formimi artistik pamore të fushes se Fotografise, duhet të këtë një shperndarje të rregullt midis kategorisë A dhe B të lendeve. Gjitashtu duhet pasur kujdes midis kontrollit të raportimit të krediteve per lende. Në rastin e lenda “Historia e Fotografise”rezulton 4 Kredite, nderkohe në sylabusin e lendes rezulton 3 Kredite.

Ndarja sipas veprimtarive formuese sipasVKM nr. 41, datë 24. 01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë”, për programet bachelor përqindja totale e lëndëve A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 70 %, në rastin konkret është 67%.

GVJ sugjeron, që të rishikohet ndarja e veprimtarive formuese në planin mësimor, në përputhshmëri me VKM nr. 41, datë 24. 01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë”.


Në lidhje me transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve studenti ka mundësinë të kryej mobilitete në kuadër të projekteve si Erasmus +, gjitashtu dhe në përfundim të studimeve studenti ka mundësinë për tu punësuar në entite të caktuara apo kompani qe cilat kurojnë imazhin. Marrëveshjet e bashkepunimit janë vertët cilesore dhe studentët dhe programi i Bachelor në “Fotografi” duhet të vijoje ti zhvilloj akoma me shumë.

Evidenca. Nr. 1.0.0 Raporti i Vlerësimit të Brendshëm të programit të studimit Bsc. në Fotografi. Tabela 10 Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10, Evidenca. Nr. 1.0.0 Raporti i Vlerësimit të Brendshëm të programit të studimit Bsc. në Fotografi. Tabela 14 Modeli i syllabuseve, elementet sipas VKM 41/20181,

	<p>Evidenca. Nr. 1.0.0 Raporti i Vlerësimit të Brendshëm të programit të studimit Bsc. në Fotografi. Tabela 10 Plani mësimor sipas modelit të Tabelës 10</p> <p>Evidenca. Nr. 1.0.0 Raporti i Vlerësimit të Brendshëm të programit të studimit Bsc. në Fotografi. Tabela 14 Modeli i syllabuseve, elementet sipas VKM 41/20181,</p> <p>Evidencë Nr. 2.04 Analizë e Tregut të Punës</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Në lidhje me syllabuset e lëndëve rishikohen çdo fillim viti akademik nga titullari/pedagogu i lëndës, konsultohen midis anëtarëve të departamentit dhe miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit, gjithashtu dhe për specifikat e programit sipas zhanrave të caktuara kryhen dhe blehje ku dikutohen mbi tematikat e mundshme. Në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, literatura dhe biblioteka është mjaft e pasur me botime të cilat janë jo vetëm baza por dhe pedagoget e angazhuar në këtë program kanë vertet kontribut në pasurimin e bibliografive për këtë program. Syllabuset e të gjitha lëndëve në këtë program studimi janë në përputhje me përcaktimet të VKM 41 datë 24.01.2018.</p> <p>Evidenca. Nr. 2.05 Syllabuset e lëndëve për programin e studimit Bachelor në “Fotografi”</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Synimi kryesor i këtij programi është ndërthurja e njohurive profesionale me ato artistike, duke nxitur vlerat artistike dhe profesionale të studentëve me nevojat e tregut të punës. Përtëj kësaj qasje program gjatë vizitës së GVJ, shihet qartë iniciativa e grupit të ngritur për këtë program në praktikimin e artit të fotografisë dhe nëpërmjet implementimit të kësaj praktike edhe në fusha të ndryshme sociale, kulturore dhe artistike.</p> <p>Evidencë. Nr. 1.06 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në “Fotografi”</p> <p>Evidencë. 1.01 Statuti i UART neni 93</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>GVJ konstaton se lëndët janë bashkëkohore, të rëndësishme dhe përmbajtja e tyre mundëson kompletimin e studentëve me njohuri bazë dhe të thelluara në fushën e fotografisë.</p> <p>Ky program i jep mundësi studentëve të vijnë studimet e tyre në institucione artistike dhe ato si dizajni multimedial në rajon dhe në institucionet artistike të vendeve europiane dhe më tej.</p>

	<p>Perpos faktit të pritshmerive të tregut të punës, dege të tilla si fotografia e cila është një zhanër që nuk ofrohet si program studimi, shërben si katalizator për të rregulluar tregun e punës me ekspert të mirefilltë në këtë fushe.</p> <p>Evidencë Nr. 1.06 Rregullorja e programit të studimit Bachelor në “Fotografi”</p> <p>Evidencë Nr1.01 Statuti i UART neni 106</p> <p>Evidencë Nr. 2.04 Analizë e Tregut të Punës</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në programin e studimit Bachelor në “Fotografi”, lëndët/modulet të cilat ofrohen japin bazën për një program bachelor në fotografi, ku studenti është i aftë për të hyrë në tregun e punës. Në strukturën e programit të Bachelor në “Fotografi” lëndë si: Fotografi, Fotografi analoge, Fotografi digjitale, Projekt portfolio, Forme, Histori fotografie., janë lëndë të cilat janë themeli i çdo programi studimor në zhanrin e fotografisë me programe të ngjashme ndërkombëtare. Duke qënë se është një program studimi 180 Kredite vihet re se shpërndarja e lëndëve në të tre vitet akademike dhe semestrat e tyre përkatës është e balancuar dhe zhvillon marrjen e dijeve në mënyrë graduale, ku dhe studenti është në gjëndje ku përgjatë dy viteve të fundit akademike të këtë përfutur bazën e programit dhe të gjithashtu ka lirshmërin për të vijuar në zhvillimin e aspektit artistik individual.</i></p> <p><i>Përqindja totale e lëndëve A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 70 %, në rastin konkret është 67%.</i></p> <p><i><u>GVJ sugjeron, që të rishikohet ndarja e veprimtarive formuese në planin mësimor, në përputhshmëri me VKM nr. 41, datë 24. 01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga insitucionet e arsimit të lartë”.</u></i></p> <p><i>Perpos faktit të pritshmerive të tregut të punës, dege të tilla si fotografia e cila është një zhanër që nuk ofrohet si program studimi, shërben si katalizator për të rregulluar tregun e punës me ekspert të mirefilltë në këtë fushe.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.5



Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Pergjate takimit të kryer në UA, një nga pikat kryesore ku dhe stafi kordinues qendron fort është bashkepunimi me institucione publike dhe jo publike në lidhje me ecurinë e programit në kordinim me tregun e punës, Marrëveshjet e bashkepunimit sëbashku dhe me konsultimet me entitete të fushes se imazhit, cultures, artit, do të sjellin dhe një aspekt rregullator per fushën e fotografise.</p> <p>Në lidhje me propozime nga student të diplomuar brezi i studenteve 2023-2024 do të jetë brezi i pare i diplomuar në këtë program studimi. Pike vertet vleresuese per këtë program është dhe fakti se bashkepunimi i UA me shkollat e mesme artistike në profilin e fotografise ofron një vazhdimesi të ketij profili dhe një pozicionim të mire jo vetëm në tregun vendas per dhe atë jasht territorit.</p> <p>Evidence. 2.0.4 Analizë e tregut të punës për programin e studimit Bsc. në Fotografi.</p> <p>Evidenca Nr. 2.06 Projektet artistike të Prog të studimit.</p> <p>Evidencë Nr. 2.04 Analizë e Tregut të Punës</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Aktualisht, brezi i studentëve të parë të regjistruar në këtë program studimi është në vitin e tretë dhe pritet të diplomohen në përfundim të këtij viti akademik, 2023-2024.</p> <p>Evidencë Nr. 2.07 Urdhëri i hapjes së programit të studimit Bsc në Fotografi</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shogata,</p>	<p>UA përtej historikut të rëndësishëm që mbart në fushën e artit, vazhdon ti japi rendesi rendësi bashkëpunimeve entiteteve të tjera për ofrimin e shërbimeve të studentëve, permes vizitave në keto entitete të cilat jo vetëm perfshijnë studentët në lidhje me praktikat por dhe tregojnë proceset e tyre.</p> <p>Në këtë kuadër bashkëpunimi me këto institucione publike, por edhe private, është arritur plotësimi i nevojave të studentëve për funksionimin dhe realizimin e programit të studimit. Liceu</p>

urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	<p>Artistik i Tiranës dhe shkollat e mesme artistike në rrethe përbëjnë prurjen kryesore për studentët e Fakultetit të Arteve të Bukura.</p> <p>Evidencë. Nr. 1.11 Lista e bashkëpunimeve kombëtare.</p> <p>Evidencë Nr. 2.04 Analizë e Tregut të Punës</p>			
Konkluzione	<p><i>Marrëveshjet e bashkëpunimit sëbashku dhe me konsultimet me entitete të fushes së imazhit, kultures, artit, sjellin një aspekt rregullator për fushën e fotografisë dhe artet pamore, faktor i cili duhet të nxitet për të diferencuar dhe ofruar vlerësimin e merituar studentëve të këtij program por dhe jo vetëm.</i></p> <p><i>UA përtej historikut të redesishem që mbart në fushën e artit, vazhdon të japi rendësi rendësi bashkëpunimeve entiteteve të tjera për ofrimin e shërbimeve të studentëve, përmes vizitave në keto entitete të cilat jo vetëm përfshijnë studentët në lidhje me praktikën por dhe tregojnë proceset e tyre. Nëpërmjet të diplomuarve të pare, suksesi i këtij programi duhet të jetë dhe në <u>sygjerimin</u> për hapjen e programit Master për "Fotografi" me profile specifike ku studentët që në shkolle të mesme të kenë rrugën e studimeve të tyre në këtë fushë të qëndrueshme.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikën më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe	Mbështetur në rregulloren e programit të studimit (1.0.6) format e mësimdhënies, për lëndët/modulet dhe orët në auditor janë si më poshtë:

<p>transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Leksione • Seminare / Ushtrime • Projektet artistike • Praktikrat mësimore dhe profesionale • Tezë Diplome <p>Evidenca 1.0.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Fotografi</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Nga dokumentacioni vëne në dispozicion dhe nga vizita në institucion vëhet re që personeli akademik i përgjigjet nevojave të studenteve si në ofrimin e njohurive teorike po ashtu dhe në formimin praktik e artistik. Format e mësimdhënies bazohen kryesisht në punë krijuese, e cila zhvillohet nën mbikëqyrjen e personelit akademik dhe në një komunikim të vazhdueshëm me studentin. Nga biseda në institucion me studentet dhe nga evidencat e paraqitura (2.0.6, 3.13, 3.15), konstatohet një numër i konsiderueshëm aktiviteteve ku studentet janë aktive.</p> <p>Evidenca 2.0.6. Projektet artistike të programit të studimit Bsc në Fotografi;</p> <p>Evidenca 3.13. Fletëpalosje me kalendarin e aktiviteteve të ndryshme të realizuara nga studentët dhe stafi akademik i FAB;</p> <p>Evidenca 3.15. Projekte artistike të studentëve të programit Bsc në Fotografi, të mbështetura nga Departamenti;</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve.</p>	<p>Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve. Si evidence janë mobilitet e ndryshme ku stafi është i angazhuar (3.0.1). Në raportin vjetor të Departamentit të Arteve të Aplikuara evidentohet nevoja për një mbështetje më të madhe institucionale për pjesëmarrje në konferenca (6.0.5).</p> <p>Evidenca 3.0.1. Të dhëna mbi kualifikimin dhe kërkimin artistiko shkencor të stafit akademik në kuadër të projektit Erasmus dhe Erasmus+;</p> <p>Evidenca 6.0.5. Raporti vjetor i Departamentit për tre vitet e fundit për analizën për procesin mësimor, rezultatet e vlerësimit dhe adresimin e mangësive.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive</p>	<p>Nga vizita në institucion , përmes kontakteve të drejtpërdrejta me stafin dhe studentët vërehet se angazhimi i stafit akademik është i plotë në lidhje me nevojat e programit të studimit. Kualifikimi i personelit akademik është në përputhje me</p>

<p>dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>kërkesat për një program studimi të nivelit Bachelor (Tabela 7).</p> <p>Në funksion të performancës një pjese e tyre ka angazhim në disa procese në përputhje me nevojat e programit të studimit. Studentët fillojnë që nga viti i parë të punojnë në përgatitjen e projekteve nën mbikëqyrjen e pedagogut të tyre për çdo lëndë përkatëse në varësi të silabuseve. Disiplina e programit te jep mundësinë për një kontakt te afërt me studentit, e cila siguron mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë.</p> <p>Evidenca Tabela 7.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Format dhe metodat e mësimdhënies analizohen në mënyrë periodike duke iu referuar takimeve të vazhdueshme me studentet por si evidence e matshme është anketimi dhe pyetësori i lidhur me mësimdhënien (3.0.6). Rezultatet e marra nga pyetësori analizohen në procesin e rishikimit periodik të programit të studimit dhe të analizës vjetore të departamentit.</p> <p>Pjesmarrja e studentëve në rastin e këtij programi garantohet edhe nga numri i vogël i studentëve dhe marrëdhënia e tyre e vazhduar dhe direkte me personelin akademik, tipike të programeve të formimit në arte.</p> <p>Evidenca 3.0.6. Të dhëna nga pyetësori i studentëve të programit Bsc. në Fotografi;</p> <p>Evidenca 6.0.5. Raporti vjetor i Departamentit për tre vitet e fundit për analizën për procesin mësimor, rezultatet e vlerësimit dhe adresimin e mangësive.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse</p>	<p>UA ka struktura në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies (shih Kreu VI). Gjithsesi, puna konkrete dhe mbarvajtja e aktivitetit kryhet nga departamenti. Për nga vetë natyra në fushën e arteve, mësimdhënia është gjithmonë në kërkim të formave të reja dhe kreative. Këtu ndikojnë mjaft edhe aktivitetet e shumta artistike të cilat janë forma të hapura shkëmbimi qasjesh, metodologjish dhe perspektivash. Gjithashtu, tradita shumëvjeçare e institucionit trashëgohet brez pas brezi duke krijuar baza të shëndetshme për proceset e mësimdhënies.</p> <p>Gjatë COVID 19 u aplikuan edhe forma të komunikimit online për zhvillimin e procesit mësimor. Trajnimi i personelit bëhet</p>

mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	edhe përmes mobiliteteve dhe pjesëmarrjes në projekte të përbashkëta me universitetet partnere. Evidenca 2.0.6 Projektet artistike të programit të studimit Bsc në Fotografi; Evidenca 3.13 Fletëpalosje me kalendarin e aktiviteteve të ndryshme të realizuara nga studentët dhe stafi akademik i FAB; Evidenca 3.15 Projekte artistike të studentëve të programit Bsc në Fotografi, të mbështetura nga Departamenti. Evidenca 3.0.1 Të dhëna mbi kualifikimin dhe kërkimin artistiko shkencor të stafit akademik në kuadër të projektit Erasmus dhe Erasmus+.			
Konkluzione	<i>UA, mbështetur edhe në eksperiencën e tij në formimin e artistëve ndër vite, garanton procesin e të nxënies dhe aftësimin profesional e artistik me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. Universiteti përdor forma mësimdhënie të përshtatshme për disiplinat e arteve dhe bazon mësimdhënien në proceset krijuese. Aktivitetet kurrikulare dhe ekstrakurrikulare dëshmojnë një mjedis të konsoliduar artistik e akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në rregulloren e programit dhe në rregulloren e përgjithshme të UART (1.0.6, 1.0.4, 1.0.3), që janë publike online. Vlerësimi bëhet me notë, ku nota më e ulët kaluese është 5 ndërsa më e larta 10. Në llogaritjen e notës merren në konsideratë vlerësimet e ndërmjetme gjatë semestrit. Modalitetet përcaktohen në silabusin e çdo lënde (2.05). http://www.artacademy.al/index.php?pg=fage&id=1156&niveli=77
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët	Nga takimi me studentët rezulton se ata janë të informuar për objektivat e kursit, temat, materialin e detyrueshëm dhe të


<p>informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>rekomanduar për lexim, metodën e vlerësimit dhe rezultatet e të nxënit. Ky informacion vihet në dispozicion nga personeli akademik në fillim të çdo lënde. Metodatat e vlerësimit të lëndëve janë paraqitur në pjesën përkatëse të silabusit. Studentët mund të shohin të gjithë numrin dhe shumëllojshmërinë e metodave të vlerësimit të aplikuara për lëndën specifike (provim, detyrë, detyra shtëpie etj.) si dhe përqindjen e secilës detyrë që ndikon në notën përfundimtare (2.0.5). Ndërkohë, plani mësimor është i aksesueshëm online.</p> <p>http://uart.edu.al/media/Plani%20M%C3%ABsimor%20Bsc%20Fotografi.pdf</p> <p>Evidenca 2.0.5. Syllabuset e lëndëve.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e artistike realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Këto japin mundësi studentit të demonstrojë njohuritë qofte me gojë, me shkrim apo me projekte artistike apo detyra kursi. (2.0.5) Siç përmendet në Kriterin 1 të Standardit III.1, në rregulloren e programit të studimit (1.0.6) format e mësimdhënies, për lëndët/modulet dhe orët në auditor janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Leksione • Seminare / Ushtrime • Projektet artistike • Praktikat mësimore dhe profesionale • Tezë Diplome <p>Evidenca 2.0.5. Syllabuset e lëndëve;</p> <p>Evidenca 1.0.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Fotografi.</p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Departamenti i Arteve të Aplikuara menaxhon dhe rishikon përmbajtjen e mësimdhënies dhe format e saj. Departamenti është në komunikim të vazhdueshëm me studentët përmes aktiviteteve mësimore. Sektori mësimor gjithashtu realizon sondazhe mbi programin e studimit me studentët dhe personelin akademik (5.10, 5.11).</p> <p>Duhet theksuar se, duke qenë një universitet i vogël, është e lehtë që secili të dëgjohet. Universiteti rezulton të jetë një komunitet gjithëpërfshirës dhe në të njëjtën kohë, komunikimi ndërmjet të gjithë aktorëve është relativisht i lehtë dhe efikas.</p> <p>Evidenca 5.10. Rezultatet e sondazhit të kryer nga Sektori Mësimor për studentët dhe stafin akademik;</p>

	Evidenca 5.11. Raporti mbi pyetësoin e stafit të FAB, Gusht 2022.			
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Për vetë natyrën e fushave që mbulon, UART eksploron dhe zhvillon forma kreative dhe nxitëse të mësimdhënies. Workshopet dhe projektet artistike janë forma përmes së cilave synohet nxitja e individualitetit të studentit dhe eksplorimi i qasjeve të shumëllojshme për të mbërritur tek produkti artistik. Në të shumtën e rasteve mësimdhënia zhvillohet në grupe të vogla apo përmes konsultave individuale, ku studenti është vazhdimisht i mbështetur nga personeli akademik. Kjo krijon edhe një komunikim të afërt mes palëve; praktikë sa pozitive aq edhe e domosdoshme për disiplinat e artit. Sa më sipër u konfirmua në takimet me studentët dhe personelin akademik si dhe përmes njohjes me punët e studenteve dhe me ambientet e atelieve dhe laboratorëve specifikë për programin e studimit.			
Konkluzione	<i>U konstatua se UA ka rregulloret dhe dokumentacionin e plotë për zhvillimin e programit të studimit. Këto rregullore janë hartuar në përputhje me nevojat specifike të universitetit dhe ato të programit të studimit BSc. Në Fotografi. Njëkohësisht, zhvillimi i procesit, informimi dhe përfshirja e studentëve në të janë në nivel të kënaqshëm. Metodatat e mësimdhënies janë në përputhje me nevojat e programit të studimit dhe vlerësohen efektive për realizimin e objektivave të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive,	Kontrolli i njohurive bazohet në forma kontrolli të vazhdueshme përgjatë semestrit. Në bazë të lëndëve, pesha e



<p>dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>komponentëve të vlerësimit varion. Në lëndët profesionale, vlerësimi përgjithësisht ndahet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Frekuentimi: 10% • Projektet, detyrat dhe puna krijuese: 60% • Provimi: 30% <p>Shkalla e përvetësimit të dijës nga studentët bëhet sipas sistemit me notë (notat 1 deri 10). Nota kaluese është nota 5. Kjo praktikë është mëse e drejtë dhe e barasvlershme në rang kombëtar dhe më tej. Te gjitha këto janë të parashikuara në syllabuset e lëndëve nga titullari i lëndës (2.0.5, Tabela 15).</p> <p>Evidenca 2.05. Syllabuset e lëndëve;</p> <p>Evidenca Tabela 15.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Për vetë natyrën e programit (me projekte artistike dhe punë krijuese) dhe numrin e vogël të studentëve, vlerësimi elektronik nuk është një opsion i dobishëm. Vlerësimet jepen gjatë prezantimeve publike të punës, mbrojtjes së detyrave apo ekspozitave, ku mundësohet edhe transparenca kundrejt audiencës.</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin, rregulloren e programit të studimit dhe bazën ligjore në fuqi. Piket e akumuluarra nga studenti gjate semestrit përllongariten ne notën finale. (2.0.5, 1.0.5, Tabela 15).</p> <p>Evidenca 2.05. Syllabuset e lëndëve;</p> <p>Evidenca 1.05. Rregullore e Departamentit të Arteve të Aplikuara;</p> <p>Evidenca Tabela 15.</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Vlerësimi i njohurive në lidhje me dorëzimet dhe prezantimet dhe komentet mbi këtë vlerësim realizohen në kohë reale, si në konsultimet periodike, ashtu edhe në vlerësimin përfundimtar të detyrave apo projekteve artistike. Kjo mënyrë është tipike (dhe e domosdoshme) në disiplinat e formimit artistik. Komunikimi dhe feedback-u i vazhdueshëm u konfirmua edhe nga takimi me studentët në institucion.</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli</p>	<p>Është personeli akademik qe është i detyruar të bëjë kontrollin e vazhdueshëm të punëve te studenteve. Puna e këtyre të fundit</p>

<p>akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>arkivohet në format fizik apo digjital, gjë që bën të mundur edhe kontrollin për plagjiaturë. Ndërkohë konsultimet në lëndet formuese/artistike shmangin kopjimin duke mbajtur nën kontroll të vazhdueshëm dhe duke orientuar ecurinë e punës. Detyrimet e studentit për sjelljen dhe etikën akademike përcaktohen në rregulloren e programit të studimit (1.0.6, Neni 33).</p> <p>Evidenca 1.06. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Fotografi.</p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rezultatet e provime dokumentohen në Procesverbalet e provimeve, si dhe në Regjistrin e Rezultateve Akademike. Këto procesverbale dokumentohen në sekretarinë mësimore. Nuk u konstatua vonesë në dhënien e rezultateve. Studentët aksesojnë lehtësisht vlerësimet përfundimtare edhe përmes sistemit PITAGORA, të mundësuar nga RASH (Rrjeti Akademik Shqiptar) (4.16, 4.18).</p> <p>Evidenca 4.16. Screenshot nga sistemi Pitagora;</p> <p>Evidenca 4.18. PITAGORA - Manuali i përdorimit për Sekretarinë Mesimore dhe studentet.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Referuar rregullores së programit të studimit (1.0.6), Neni 19, përcaktohen mënyrat e vlerësimit të studentit dhe mundësitë e ankimit. Komunikimi i rezultateve bëhet në një seancë të posaçme ku studenti ka mundësi të njihet me vlerësimin dhe të shprehë mendimin e tij. Brenda 24 orëve nga marrja e rezultatit, studenti ka mundësi të ankohet për rezultatin. Në këto raste, Dekani pasi verifikon rastin, konsultohet me drejtuesin e departamentit dhe jep edhe vlerësimin përfundimtar për rishikim apo mbetje në fuqi të vlerësimit.</p> <p>Gjatë vizitës së GVJ, nuk u identifikua asnjë rast konkret ankimi.</p> <p>Evidenca 1.06. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Fotografi.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UA, përmes rregulloreve dhe praktikës së konsoliduar rezulton se siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit. U konstatua se universiteti ka rregullore dhe dokumentacion të</i></p>

	<i>plotë në këtë drejtim, ndonëse nuk u evidentuan raste specifike ankimi për programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Programi i studimit Bachelor në Fotografi jep njohuritë dhe aftësitë siç tregohen nga lëndët e paraqitura në planin mësimor (3.0.9) të programit të studimit. Studentët marrin një sërë kursesh brenda disiplinave të fotografisë, si dhe disa lëndë të tjera që lidhen me fushën e studimit. Përveç kurrikulave, studentët marrin pjesë rregullisht edhe në aktivitete artistike që zhvillohen rregullisht në UA.</p> <p>Plani mësimor është i ndërtuar përgjithësisht brenda veprimtarive formuese të kërkuara nga VKM 41/2018 dhe 185/2021.</p> <p><i>Sugjerohet te ri-konsiderohen veprimtaritë e kategorisë (A) "LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme" të cilat rezultojnë 10% kundrejt 15-20% të parashikuar nga VKM si dhe veprimtaritë e kategorisë (B) "LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën shkencore dhe artistike" të cilat rezultojnë 57% kundrejt 50-55% të parashikuar nga VKM.</i></p> <p>Kjo mund të arrihet edhe pa cenuar përmbajtjen e programit, përmes zhvendosjes së njëres prej lëndëve "Teori e fushës" / "Teori e ngjyrës" / "Vëllim në hapësirë" nga kategoria B në kategorinë A, pasi nga përmbajtja ato mund të shihen edhe si lëndë metodologjike.</p> <p>Evidenca 3.09. Plani Mësimor i programit të studimit Bsc. në Fotografi.</p>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së	<p>Programi është në përputhje me kërkesat e programeve të ciklit të parë duke ofruar 14% të krediteve në kategorinë (D) për të garantuar njohuri informatike, praktike dhe gjuhë të huaj (3.0.9).</p>

<p>informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Evidenca 3.09. Plani Mësimor i programit të studimit Bsc. në Fotografi.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studentit, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Kompetencat dhe aftësitë që fiton studentit janë të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde (2.0.5).</p> <p>Duke iu referuar takimit me drejtuesit e njësisë baze dhe asaj kryesore konstatojmë se çdo instruktor i lëndës kryen një rishikim të përfundimtar ku vlerëson njohuritë e marra, metodologjinë e përdorur dhe aspekte të tjera të rëndësishme për lëndën. Vlerësimi i njohurive në lidhje me dorëzimet dhe prezantimet dhe komentet mbi këtë vlerësim realizohen në kohë reale, si në konsultimet periodike, ashtu edhe në vlerësimin përfundimtar të detyrave apo projekteve artistike. Kjo mënyrë është tipike (dhe e domosdoshme) në disiplinat e formimit artistik. Komunikimi dhe feedback-u i vazhdueshëm u konfirmua edhe nga takimi me studentët në institucion. Gjithashtu, departamenti kryen edhe analiza vjetore (6.0.5) ku shqyrtohet ecuria e procesit mësimor dhe mundësitë për ndryshime / përditësime të planit e programeve.</p> <p>Evidenca 2.0.5. Syllabuset e lëndëve;</p> <p>Evidenca 6.0.5. Raporti vjetor i Departamentit për tre vitet e fundit për analizën për procesin mësimor, rezultatet e vlerësimit dhe adresimin e mangësive.</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet</p>	<p>Duke iu referuar silabuseve (2.0.5) por edhe takimeve me lektoret dhe studentet në institucion konkludojmë se personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative . Përfshirja e studenteve projekte dhe aktivitete artistike (3.13, 6.06) dhe mobiliteti i lektoreve dhe studentëve (3.0.1, 3.12) mundëson ndërthurjen e formave të mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese.</p> <p>Evidenca 2.0.5. Syllabuset e lëndëve;</p> <p>Evidenca 3.13. Fletëpalosje me kalendarin e aktiviteteve të ndryshme të realizuara nga studentët dhe stafi akademik i FAB;</p> <p>Evidenca 3.01. Të dhëna mbi kualifikimin dhe kërkimin artistiko shkencor të stafit akademik në kuadër të projektit Erasmus dhe Erasmus+;</p> <p>Evidenca 3.12. Të dhëna për mobilitetin e studentëve për programin e studimit Bsc. në Fotografi.</p>

ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.									
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	<p>Stafi akademik i departamentit është i angazhuar në vazhdimësi me veprimtari artistike jashtë programit të studimit. Gjithashtu, aktivitetet e pasura artistike të UART janë një mundësi e mirë për studentët për të thelluar formimin e tyre artistik përtej kurrikulës (3.13, 6.06). Galeria FAB që menaxhohet nga Fakulteti i Arteve të Bukura është aktualisht edhe hapësira më e rëndësishme publike e ekspozimit të artit në kryeqytet.</p> <p>Evidenca 3.13. Fletëpalosje me kalendarin e aktiviteteve të ndryshme të realizuara nga studentët dhe stafi akademik i FAB;</p>								
Konkluzione	<i>Nga shqyrtimi i përmbajtjes së dokumentacionit, rezulton se programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e teknike tek studentët dhe synon zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e artistike. Metodot e mësimdhënies, aktivitetet kurrikulare e ato ekstrakurrikulare krijojnë një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e studentëve dhe për realizimin e objektivave të programit. Sugjerohet të rikonsiderohen veprimtaritë e kategorisë A dhe B të planit mësimor.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për	<p>Modalitetet për punimin e diplomës janë të përcaktuara në rregulloren e përgjithshme dhe rregulloren e programit të studimit (1.0.2, 1.0.6).</p> <p>Neni 25 dhe 26 i rregullores së programit të studimit përcakton ndër të tjera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Diploma mund të realizohet si temë teorike, mbrojtje artistike, apo një ndërthurje e të dyjave;

<p>punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Studenti duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet studimore dhe institucionale përpara mbrojtjes së diplomës; - Temat e diplomës përcaktohen brenda dy muajsh nga fillimi i vitit akademik; - Punimi i diplomës mund të realizohet individualisht ose në grup (duke përcaktuar rolet e secilit student); - Udhëheqësi i diplomës përcakton edhe grafikun e punës për realizimin e saj; - Njësia bazë realizon kontrole periodike të ecurisë; - Mbrojtja e diplomës është publike dhe me komision. <p>Evidenca 1.0.2. Rregullore e UART;</p> <p>Evidenca 1.0.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Fotografi.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Personeli akademik asiston studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. Programi i studimit është në përmbyllje të ciklit të parë të diplomave. Duke qenë një universitet me numër të vogël studentësh, komunikimi dhe marrja e informacionit realizohet lehtësisht.</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Programi si detyrim përmbyllës ka mbrojtjen artistike ose temat teorike të cilat zhvillohen si tema me kompleksitet të gjerë dhe ku duhet të shprehen qartë njohuritë e studentit të përfituara në të tre vitet e studimit.</p> <p>Kjo mënyrë është e mirënjohur në shkollat e artit dhe vlerësohet e drejtë kundrejt provimeve klasike.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar.</p>	<p>Sipas rregullores së programit të studimit (1.0.6) departamenti përcakton temat udhëzuese të diplomës. Studenti ka të drejtë të zgjdhë ose të propozojë së bashku me udhëheqësin. Udhëheqësi i diplomës, i caktuar nga departamenti ose i dakordësuar midis studentit dhe pedagogut, këshillon vazhdimisht studentit në mënyrë që të përmbushë kriteret për prezantimin final në lidhje me të gjithë elementët e nevojshëm për te përmbyllur detyrimet.</p> <p>Udhëheqësi përcakton grafikun e punës së studentit dhe organizon konsultimet periodike. Udhëheqësi i tezës ë vendos</p>

<p>Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>nëse studenti është i gatshëm të prezantojë punën e tij përpara një komisioni.</p> <p>Evidenca 1.0.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Fotografi.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Laboratori i fotografisë është infrastruktura më e rëndësishme e programit dhe vihet në dispozicion të studentëve për realizimin e projekteve të tyre akademike dhe punimit të diplomës. Gjithashtu departamenti mbështet projektet artistike ku përfshihen edhe studentët (3.15).</p> <p>Evidenca 3.15. Projekte artistike të studentëve të programit Bsc në Fotografi, të mbështetura nga Departamenti.</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Ne përfundim të prezantimit të temës së diplomës studente vlerësohet nga komisioni i posaçëm me note. Nota vendoset nga anëtarët e komisionit sipas procedurës së përcaktuar në rregulloren e studimeve të ciklit të parë (1.0.3, Neni 34).</p> <p>Evidenca 1.0.3. Rregullore e Ciklit të parë të studimeve Bachelor.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Modeli i diplomës dhe suplementi janë të paraqitur (3.14) në përputhje me aktet ligjore. UART nuk ka lëshuar ende diploma për këtë program studimi pasi parakusht është procesi i akreditimit.</p> <p>Evidenca 3.14. Diploma, Suplementi i Diplomës (në proces).</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Të gjitha dokumentet e studentëve arkivohen gjatë studimeve të tyre sipas kërkesave të direktivës së vitit përkatës dhe një kopje e tyre arkivohet edhe pas diplomimit të studentit dhe mbetet në dosjen e studentit në të njëjtën mënyrë si gjatë periudhës së studimit. Materialet ruhen si në hard copy, ashtu edhe në mënyrë elektronike nga sekretaria mësimore. Herë pas here, studentët kërkojnë lloje të ndryshme dokumentesh për të vërtetuar studimet e tyre për arsye të ndryshme.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblyëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm. Në rregulloret përkatëse pasqyrohen në mënyrë të hollësishme të gjithë hapat për</i></p>

	<i>diplomimin e studentëve. Në momentin e akreditimit nuk ka pasur të diplomuar, megjithatë, procedura e diplomimit dhe pajisjes së studentëve me dokumentacionin përkatës rezulton e kolauduar në programet e tjera të studimit (të ngjashme) të ofruara nga universiteti.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	<p>Bazuar në informacionin e paraqitur në raportin e vetëvlerësimit (RVB), dokumentacionin shoqërues të RVB-së, si dhe informacionin e marrë në takimet e realizuara gjatë vizitës në Universitetin e Arteve, GVJ konstaton se institucioni mban të dhëna të plota mbi personelin e angazhuar në këtë program studimi, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe statutin e UA. Gjithashtu, GVJ konstaton se fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon këtë program studimi është në përputhje me natyrën e programit si edhe cilësitë specifike të moduleve të tij.</p> <p>Në këtë program studimi, referuar Tabelës përmbledhëse-Tabelat 6.1-6.3, të dhënat për stafin e angazhuar për mësimdhënie gjatë tre viteve akademike janë të njëjta dhe paraqiten si vijon:</p> <p>Për të tre vitet akademike në këtë program studimi janë angazhuar gjithsej 23 pedagogë nga ku:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> • 17 PAE, nga të cilët 2 me titullin “Profesor”, 2 me titullin “Profesor i Asocuar”, 6 me gradën “Doktor” dhe 7 me Msc; • 6 PAK, nga të cilët 1 me titullin “Profesor i Asocuar”, 1 me gradën “Doktor” dhe 4 me Msc; <p>Programi për të tre vitet akademike është mbuluar në nivelin 73% nga PAE.</p> <p>Evidencë Ligji për Arsimin e Lartë Nr. 80/2015</p> <p>Evidencë Udhëzimi Nr. 29, datë 10.09.2018, i ndryshuar</p> <p>Evidencë Nr.4.01 VKM Nr. 329, datë 12.04.2017 “Për staturisn dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”</p> <p>Evidencë. Nr. 4.02 Statusi i veçantë i UART,</p> <p>Evidencë Tabela Nr. 2 sipas modelit të tabelave të ASCAL - Tabelat e stafit akademik FAB</p>																				
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstaton se angazhimi i personelit akademik efektiv në këtë program studimi është në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, duke plotësuar kushtet e kërkuara nga Ligji i Arsimit të Lartë për të dhënë mësim në Institucionet e Arsimit të Lartë. Kurrikula e këtij programi mbulohet kryesisht me personel akademik efektiv. Numri dhe raporti i orëve mësimore të realizuara nga stafet akademike PAE / PAK në tre vitet e fundit akademike (sipas të dhënave të tabelës 12 në RVB) jepet në vijim dhe është në përputhje me kërkesat sipas legjislacionit në fuqi sipas të cilit PAE duhet të realizojnë të paktën 75% të ngarkesës mësimore në auditor. Referuar Tabelave përmbledhëse- Tabelat 12.1-12.3, u konstatua se ngarkesa mësimore e personelit akademik për tre vite akademike është si më poshtë vijon:</p> <table border="1" data-bbox="592 1491 1362 1785"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Total orësh</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE/PAK (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2021-2022</td> <td>2775</td> <td>2205</td> <td>570</td> <td>80% / 20%</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>2825</td> <td>2255</td> <td>570</td> <td>80% / 20%</td> </tr> <tr> <td>2023-2024</td> <td>2835</td> <td>2385</td> <td>450</td> <td>84% / 16%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Në lidhje me realizimin e orëve suplementare në auditor ose mbikqyrjen e praktikave profesionale Për realizimin e tyre kanë dakortësi me drejtuesin e departamentit si dhe me miratin e</p>	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2021-2022	2775	2205	570	80% / 20%	2022-2023	2825	2255	570	80% / 20%	2023-2024	2835	2385	450	84% / 16%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																	
2021-2022	2775	2205	570	80% / 20%																	
2022-2023	2825	2255	570	80% / 20%																	
2023-2024	2835	2385	450	84% / 16%																	

	<p>Dekanit të FAB</p> <p>Evidencë Udhëzimi Nr. 29, datë 10.09.2018</p> <p>Evidencë Tabela Nr. 10 sipas modelit të tabelave të ASCAL – Plani mësimor I programit të studimit Bsc në ‘Fotografi’</p> <p>Evidencë. Nr. 4.03 Realizimi të ngarkesave 2022 -2023</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Referuar DVV, RVB dhe gjithashtu vizitës në institucion GVJ konstatoi qëndrueshmëri të personelit akademik efektiv të angazhuar në programin Bachelor në Fotografi. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Fotografi” ka nënshkruar kontratat me UA sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Gjithashtu, dhe stafi akademik me kontratë, për vetë specifiken të këtij programi, përtej zbatimit të kontratave për staf akademik me kohe të pjessëshme i kushtohet vëmëndje për të pasur një bashkëpunim sa më të gjatë. Duke qënë se është një entitet shtetëror UA është i detyruar të paguaj dhe deklaroj kërkesat ligjore.</p> <p>Evidence: 4.17 Marrëveshje vjetore tip me një pedagog</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në lidhje me rekrutimin e stafit akademik me kohë të plotë, UA shpall thirrje publike në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke pasqyruar nëpërmjet adreses zyrtare në web: http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=604&niveli=132</p> <p>Me specifikat dhe kategoritë e kërkuara. Në rastin e përzgjedhjes për staf në programin bachelor “Fotografi” rasti i pedagogut As.Lektor O. K. pasqyron më së miri dhe ecurinë e cili stafi kalon për të përmbushur hallkat e duhura për të qënë korrekt me procedure por dhe me mbulimin e moduleve të cilat programi ka nevojë. Në lidhje me rekrutimin e stafit Njësia Bazë parashikon specifike në përputhje me lëndën/ët për të cilat do të angazhohet stafi akademik; apo kategorinë e stafit akademik të kërkuar, duke caktuar dhe kriteret e pranimit të personelit akademik, në bazë të përshkrimit të vendit vakant, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, ku më pas rektori i Universitetit të Arteve formulon dokumentin informues dhe shpall publikisht në, kriteret dhe afatin për konkursin e punësimit të vendit vakant. Rektori vendos miratimin përfundimtar për të lidhur kontratën e punës me kandidatin/kandidatët e përzgjedhur.</p>

	<p>Evidence: 1.0.1 Statuti i UART</p> <p>http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=604&niveli=132</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>UA siguron dhe garanton angazhimin e stafit mbështetës akademik të përshtatshëm dhe adekuat për kryerjen e orëve praktike dhe mirëmbajtjen e ambienteve mësimore laboratorike, sipas natyrës artistike atelie të këtij programi.</p> <p>Evidencë Tabela Nr. 2 sipas modelit të tabelave të ASCAL - Tabelat e stafit akademik FAB</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Për të gjithë personelin akademik të angazhuar në procesin e mësimdhënies, efektiv apo me kontratë, përgjatë vizitës së GVJ u vu re plotësimi dhe arkivimi i të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar, përfshirë këtu edhe CV-të individuale të detajuara si dhe materiale të tjera të kërkuara nga Zyra e Burimeve Njerëzore pjese e UA.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore disponon databazën e plotë për të gjithë personelin akademik të angazhuar në programin e studimit, së bashku me dokumentacionet e nevojshme ligjore për gjithësecilin. Fakulteti gjithashtu, disponon ngarkesën e stafit për secilin semestër (orët totale), angazhimin e tij në lëndët përkatëse, si edhe komunikon në mënyrë të vazhdueshme me Përgjegjësën e Departamentit në lidhje me ecurinë e procesit mësimor.</p> <p>Evidenca Nr. 4.04 Realizimi i Marrëveshjeve vjetore e FAB</p> <p>Evidencë Udhëzimi Nr. 29, datë 10.09.2018</p> <p>Evidencë. Nr. 4.01 VKM Nr. 329, datë 12.04.2017</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në</p>	<p>UA dhe FAB, kane nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi me institucione/kompani partnere, duke u mundësuar studentëve të te programit Bachelor “Fotografi” të përfitojnë nga mundësia për të kryer praktikën e tyre në institucionet/kompanitë partnere. Ata mund të përfitojnë nga kushtet adekuate dhe të përshtatshme të punës u jep studenteve një shije të vërtetë të procesit te punes. Në të njëjtën kohë, institucionet/kompanitë</p>

<p>dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>partnere asistojnë me infrastrukturën dhe profesionalizmin e tyre. Ne kete rast praktikat mesimore caktohen pedagogë, në varësi të numrit të studentëve, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, pika II, nr. 12, gërma “e”, për të ndjekur praktikën dhe për të mbajtur kontakt me institucionin pritës.</p> <p>Evidencë. Nr. 4.05 Dosja e Praktikës Profesionale</p> <p>Evidence. 3.15 Projekte artistike të studentëve të programit Bsc në Fotografi, të mbështetura nga Departamenti.pdf</p> <p>Evidence. 1.11 Marrëveshje Bashkëpunimi të UART me institucione të tjera..pdf</p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Praktikat profesionale janë pjesë e planeve mësimore dhe përmban 6 kredite sipas planit mësimorë <u>Tabela 10</u> dhe i përket Veprimtarive Formuese D sipas <u>Tabela 9</u>. Në kuadër të vlerësimit të studentit për praktikat mësimore sipas po Tabelës 10 studenti vlerësohet me “Provim”.</p> <p>Gjithmon sipas RVB së dorëzuar, shkruhet se në përfundim të praktikës, përfaqësuesi i institucionit pritës jep vlerësimin e tij për çdo student të mbikëqyrur. <u>Sygjerohet të hartohet një dokument përcjellës për të evidentuar këtë proces.</u></p> <p>Evidencë Tabela Nr. 9 sipas modelit të tabelave të ASCAL - Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E).</p> <p>Evidencë Tabela Nr. 10 sipas modelit të tabelave të ASCAL - Plani mësimor sipas modelit të (Zëvendësohet me Planin tonë mësimor).</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>FAB/UART si institucioni i vetëm arsimor publik në fushën e artit, personeli akademik me kohë të plotë dhe me kontratë, jo vetëm që i përputhen fushave të studimit të cilat ata janë pjesë, por dhe kanë një përvojë artistike dhe janë aktivë në fushën e artit.</i></p> <p><i>UA mbështetur në kornizën ligjore në fuqi, përcakton organizimin e brendshëm akademik si dhe administrativ të tij. Njësitë ndihmëse si strukturë ndihmëse luajnë një rol të rëndësishëm. Për programin e studimit në Bachelor “Fotografi” në përputhje me parashikimet e planit mësimor, studenti duhet të realizojnë praktikat profesionale. FAB sëbashku dhe me kordinatorin e programit ka të nënshkuara marrëveshje bashkëpunimi me institucione në fushën e artit, ose biznesin privat pranë të cilave do të zhvillohet praktikat</i></p>

	<i>mësimore. <u>Sygjerohet</u> të hartohet një dokument përcjellës për të evidentuar vlerësimin e studentit nga institucioni pritës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>Përgjatë vizitës së kryer në UA, GVJ konstatoi se laboratorët dhe ateliet për programin e studimit ishin mjaft mirë, duke mundësuar mjaftueshëm zhvillimin e një procesi mësimor sa më të përshtatshëm. Gjatë vizitës u pa dhe “Dhoma e erret” e cila përdoret nga studentët për programin përkatës duke ofruar bazën e një laboratorit zhvillues për fotografimin analoge, si dhe atelie dixhitale ku studentët kanë mundësi të punojnë me fotografimin dixhitale si dhe ndricimin.</p> <p><i>Megjithëse këtij programi për momentin ka hapësirë ku studenti mund të ushtronte krijimtarinë e tij, <u>sygjerohet</u> të vihen në dispozicion salla/laboratore të tjerë për programin.</i></p> <p>Evidenca Nr. 4.06 Dosja e infrastrukturës FAB dhe ambienteve të përbashkëta</p>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	<p>Ateliet ku realizohet procesi mësimor për programin e studimit Bachelor në “Fotografi” janë të pajisura me aparaturat e teknologjisë analoge. Duke marrë në konsideratë se “Fotografia” si zhanër studimi lidh artin me shkencën, mjetet e teknologjisë janë të nevojshme për zhvillimin e lëndëve dixhitale. Modernizimi dhe pasurimi i mëtejshëm e laboratorëve është një nga kriteret i cili duhet të vijoj dhe të investohet më shumë për të rritur kapacitete e programit dhe vlerën e tij në tregun e punës. Bibloteka, apo dhe mjediset e tjera mbështetëse të programeve të tjera të studimit së bashku me infrastrukturën dhe pajisjet që disponojnë, janë gjithmonë në shërbim të realizimit jo vetëm të procesit mësimor, por edhe të projekteve artistike.</p>

	<p>Evidenca Nr. 4.06 Dosja e infrastrukturës FAB dhe ambienteve të përbashkëta</p> <p>Evidenca Nr. 4.07 Lista e pajisjeve në shërbim të FAB për vitet 2022 - 2025</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Natyra specifike e programit të Bachelor “Fotografi” kërkon të këtë një game të gjere produktesh dhe aparaturash për përdorim nga studentët. Përpos faktit që vetë sot studentët të zhanrave të ndryshme artistike mund të kene aparat fotografike, ne programin përkatës ka një sere aparaturash mjaft cilesore, të cilat mundesojne me se miri cilesi ne program. Duke qene se është program i ri tek UART, zhaner e cila nderlidh artin me procesin e teknologjise, duhet të investohet me shumë ne zgjerimin e laboratoreve si dhe aparaturave të tjera të tjera, kjo për të rritur kapacitet për student të ardhshem dhe për të garantuar cilesi ne mesimdhënie.</p> <p>Evidenca Nr. 4.06 Dosja e infrastrukturës FAB dhe ambienteve të përbashkëta</p> <p>Evidenca Nr. 4.07 Lista e pajisjeve në shërbim të FAB për vitet 2022 - 2025</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Përgjatë vizitës GVJ, pati mundesine të zhvilloje dhe vizita ne laboratore të multim medias, të cilet ofronin teknologji me pajisjet më moderne të teknologjisë në ndihmë të zhvillimin të mësimit të programit Bachelor në “Fotografi”.</p> <p>Gjitashtu programet profesionale të cilet studentët përdorin jane ato të paketës ADOBE, të cilat i përkojne dhe programeve të cilat studio dixhitale artistike përdorin dhe jane ne përputhje me tregun si vendas dhe atë jasht vendit. Përveç kësaj një hapësirë e përdorshme është dhe ajo e Bibliotekës Shkencore të UART, e pajisur me rreth 20 PC dhe programe profesionalë.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UA disponon laboratore dhe atilet për programin e studimit, duke mundësuar mjaftueshëm zhvillimin e një procesi mësimesor sa më të përshtatshëm. Ateliet ku realizohet procesi mësimesor për programin e studimit Bachelor në “Fotografi” janë të pajisura me aparaturat e teknologjisë analoge. Përgjatë vizitës ne GVJ, pati mundesine të zhvilloje dhe vizita ne laboratore të multim medias, të cilet ofronin teknologji me pajisjet më moderne të teknologjisë në ndihmë të zhvillimin të mësimit të programit Bachelor në “Fotografi”.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Specifika e programit kërkon të këtë një gamë të gjere publikimesh të cilat jo vetëm bazohen ne përdorimin e teknologjise se fotografise analoge dhe asaj dixhitale, apo literature të cilen tregon mbi historine e fotografise botërore, shqiptare apo dhe për artistë të cilet bazojne punen e tyre artistike nepërmjet zhanres se fotografise. Literatura bazë dhe ndihmëse, për çdo lëndë të Programit të Studimit Bachelor në “Fotografi”, parashikohet në programin e çdo lënde. Disponimi i literaturës bazë dhe ndihmëse parashikohet në përputhje me Rregulloren e FAB. Rrjedhimisht studentëve ju mundësohet qasja në literaturën e lëndës sipas formave të parashikuara, dixhitale apo fizike ne bibloteken e UART.</p> <p>Evidencë. Nr. 3.09 Kurrikula e Programit të Studimit</p> <p>Evidenca Nr. 4.08 Lista e literaturës FAB në Bibliotekën e UART</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ, konstatoi se ka rakordim midis Departamentit të Arteve të Aplikuara ku ne fillim të çdo viti akademik njoftohen pedagogët e lëndëve për afatet e rishikimit të programeve të lëndëve duke pare nese është e nevojshme të rishikohen programet apo dhe përditësimi i literaturës bazë dhe apo asaj ndihmëse. Duke marre ne konsiderate dhe natyren specifike të zhanrit të “Fotografise” bibloteka ne UA disponon botime të zhanrit të fotografise, nga autore të huaj dhe vendas, gjitashtu dhe autore nga vetë Departamenti i Arteve të Aplikuara.</p> <p><i>Duhet theksuar se në mungesë të një tregu të mirëfilltë për botime të mirëfillta artistike në gjuhën shqipe, literatura është kushtëzuar të jetë në masë të konsiderueshme në gjuhët kryesore evropiane, kryesisht në anglisht, italisht, gjermanisht dhe frëngjisht.</i></p>

	Evidenca Nr. 4.08 Lista e literaturës FAB në Bibliotekën e UART
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	<p>Theksuar dhe mesipër, gjatë vizitës së GVJ në ambientet e UA, Biblioteka e Universitetit të Arteve, disponon dy salla (laboratorë) në shërbim të studentëve, salla e Fondit të Hapur dhe salla “Media Library”, me pajisje kompjuterike të cilat përdoren nga studentët e të gjitha profileve të studimit në Universitetin e Arteve, përfshirë edhe studentët e Programit të Studimit Bachelor në “Fotografi”.</p> <p>Përpos botimeve të cilat gjenden fizikisht në Bibliotekë, studenti ka mundësi të aksesojë burimet elektronike të vetë Bibliotekës së Arteve, si dhe burime të shumta elektronike online, të cilat i janë mundësuar UART.</p> <p>http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=70&niveli=56</p>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	<p>Biblioteka e Universitetit të Arteve disponon koleksionet dhe shërbimet e saj nëpërmjet ambienteve, mbi 45,000 tituj. Ambientet në funksion të Bibliotekës së UA, janë salla me fond të hapur dhe salla me fond të mbyllur. Keto fonde ofrojnë tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe të huaja në varesi dhe të mbështetjes prej donatoreve si Fondacioni Soros, Fondacioni Anglez Instituti Gëte, Ambasada Franceze, ProHelvecia, Ambasada Amerikane, Instituti Italian i Kultures, Instituti Kanadez i Teknologjisë CIT ,libra apo revista shkencore sipas profileve të programit të studimit, keto sëbashku të përshtatshme për të mbuluar të gjitha modulet e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p> <p>Evidenca Nr. 4.09 Lista gjithëpërfshirëse e titujve fizikë në bibliotekën e UART</p> <p>http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=70&niveli=56</p>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	<p>UART disponon kushte të barabarta për studentët e programit të studimit përkatës, duke ndjekur procedurën e regjistrimit të çdo studenti për të pasur akses në ambientet e saj. Përtej fondit të hapur e të mbyllur ku studenti duhet të bëjë kërkesë, disponohet dhe salla dixhitale ku studentët kanë akses në periodiket dixhitale apo dhe në përdorimin e kompjuterave të cilat përmbajnë programe përkatëse.</p> <p>Evidenca 4.10 Rregullore e funksionimit të Bibliotekës së</p>

	<p>UART.</p> <p>Evidence 4.11 Statistika të aksesit të Bibliotekës së UART.</p> <p>Web: http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=70&niveli=56</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Si pjese dhe e vizites se grupit të GVJ por dhe përshkruar përgjatë raportit të RVB, Biblioteka e UA ka kapacitetin dhe është e pajisur me pjeset teknike dhe kompjuterike ku studenti mund të shfrytëzoj dhe punoj ne funksion të programit të studimit. Ambientet ne fjale apo salla multimediale është e pajisur me software të caktuar ne përputhje me specifiken e programit të studimit Bachelor “Fotografi”.</p> <p>Evidence 4.10 Rregullore e funksionimit të Bibliotekës së UART.</p> <p>4.0.6 Infrastruktura e FAB dhe ambjenteve të përbashkëta.</p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Biblioteka e UA funksionon në orarin 8.00-19.00 nga e hëna në të enjte, dhe deri në 16.00 të premten. Orari i punës në bibliotekë shpallet në mjediset e institucionit dhe në faqen ueb të universitetit. GVJ konstatori që Biblioteka operon sipas një rregulloreje dhe ofron shërbim studentëve cdo ditë të javës.</p> <p>Biblioteka e UA është gjithmon ne dispozicion si për studentët e programeve mesimore të ofruara dhe për stafin e programeve duke operuar ne orare përgjatë procesit mesimor si dhe përtej tyre, Neni 18 Evidenca. 4.10 Rregullorja e BSHUA.pdf</p> <p>Evidenca. 4.10 Rregullorja e BSHUA.pdf</p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për</p>	<p>Referuar RVB, cdo njësi bazë informohet periodikisht nga Biblioteka e UA ne lidhje me mundësitë dhe fondet e vëna në dispozicion të pasurimit të literaturës. Departamenti i Arteve të Aplikuara, paraqet kërkesat ne lidhje për literaturën e nevojshme dhe pasurimin e fondit të bibliotekës në funksion të Programit të Studimit Bachelor në “Fotografi”.</p> <p>Ne kuader dhe të mbledhjeve periodike ne Departament apo rishikimeve të sylabuseve për lende të caktuara, pedagoget e lendeve ne programin Bachelor “Fotografi” bejne dhe kerkesen e tyre te Përgjegjesi i Departamentit e me pas keto kerkesa sipas dhe hapesires nepërmjet fondeve përcillen tek biblioteka. Lista e titujve për programin e studimit ne Bachelor “Fotografi” mund të aksesohet dhe online për të pare dhe gamen e gjere të titujve për këtë program.</p>

<p>pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>http://37.139.117.42:8800/cgi-bin/koha/opac-search.pl?q=fotografia</p> <p>Evidencë. Nr. 4.09. Lista gjithëpërfshirëse e titujve fizikë në bibliotekën e UART</p> <p>Evidenca Nr 4.11 Statistika të aksesit të Bibliotekës së UART</p> <p>Evidenca Nr. 4.12 Procedure dhurimi për Bibliotekën e UART</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UA disponon një bibliotekë fizike e cila funksionon nga e hëna në të premte. Literatura bazë dhe ndihmëse, për çdo lëndë të Programit të Studimit Bachelor në "Fotografi", parashikohet në programin e çdo lënde. Disponimi i literaturës bazë dhe ndihmëse parashikohet në përputhje me Rregulloren e FAB. Rrjedhimisht studentëve ju mundësohet qasja në literaturën e lëndës sipas formave të parashikuara, dixhitale apo fizike në bibliotekën e UA.</i></p> <p><i>UA disponon kushte të barabarta për studentët e programit të studimit përkatës, duke ndjekur procedurën e regjistrimit të çdo studenti për të pasur akses në ambientet e saj. Përtej fondit të hapur e të mbyllur ku studenti duhet të bëjë kërkesë, disponohet dhe salla dixhitale ku studentët kanë akses në periodiket dixhitale apo dhe në përdorimin e kompjuterave të cilat përmbajnë programe përkatëse.</i></p> <p><i>Për historiku i gjatë që UA ka me një bibliotekë vertet mbreselënëse, duhet parë mundësia të investohet në zgjerimin e ambienteve për arkivimin e botimeve etj.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.4</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në</p>	<p>UA ka manaxhuar të dhënat e tij në lidhje me studentët nëpërmjet platformës "Pitagora" Kjo hapësirë gjithashtu ofron mundësinë që të gjitha zyrat brenda institucionit të kenë akses në informacionin për studentët, statusin e tyre dhe t'i ndjekin në vazhdimësi të studimeve të tyre.</p> <p>Në momentin e regjistrimit në UA, Drejtuesit e programit dhe Sekretarinë Mesimore, studentëve ju vihen në dispozicion</p>



<p>diplomim në programin e studimit.</p>	<p>kredencialet për të aksesuar sistemin përmes Website, ku UA komunikon dhe menaxhon të dhena nëpërmjet: Faqes Web të UART (http://www.uart.edu.al/);</p> <p>Dosjet e studentëve mbahen në sekretarinë mësimore, dhe arkivohen fizikisht dhe elektronikisht. Në sistem ruhet dhe dokumentohet ecuria e studentëve në mënyrë të vazhdueshme për secilën lëndë të planit mësimor, duke filluar me informacionin për lëndën (syllabusi, kreditet, semestri, viti, etj), gjithmonë komform rregulloreve përkatëse të programit dhe UA. Ndërkohë në lidhje me, aktivitetet e realizuara nga studentët përgjatë viteve të studimit publikohen në faqen web dhe rrjetet sociale të UART.</p> <p>Evidenca Nr. 4.13 Rregullorja e funksionimit të Sekretarisë Mësimore FAB</p> <p>Evidencë. Nr. 1.04 Rregullorja FAB</p> <p>Evidenca Nr. 4.14 Screenshot nga Regjistri i FAB</p> <p>Evidenca Nr. 4.15 Screenshot nga komunikimi me email me studentët dhe pedagogët e FAB</p> <p>Evidencë. Nr. 4.16 Screenshot nga sistemi Pitagora</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Përgjatë vizitës në UA për programin Bachelor “Fotografi” në zyrën e Burimeve Njëzore, ka informacion të detajuar me dosjet fizike mbi të gjithë stafin PAK/PAE të programit të studimit Bachelor në “Fotografi”.</p> <p>Sistemi duke ofruar informacion sipas aksesit, mundëson që çdo zyrë administrative apo njësi akademike ka kredencialet e saj me një numër të caktuar aktivitetesh dhe hapësirash aksesi. Duke marrë parasysh këtë shembull, studentëve i ofrohet qasje në plan programin e lëndës, vlerësimet dhe detajet që lidhen me të dhënat e tyre. Gjithashtu pedagogët kanë akses në statusin e studentit, të dhënat e kursit, duke përfshirë vlerësimin edhe komponentët e tjerë. Sekretaria Mësimore ka akses në statusin e studentit, statusin e tij dhe gjithë të dhënat e tjera akademike që kanë të bëjnë me rezultatet akademike të studentit</p> <p>Evidencë Statuti i UART</p> <p>Evidencë Udhëzimi Nr. 29 datë 10.09.2018</p> <p>Evidencë Nr. 4.17 Marrëveshje vjetore tip me një pedagog</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që</p>	<p>Përgjatë takimeve me stafin akademik studentët si dhe sekretarinë mësimore, informacioni ndërmjet personelit akademik dhe studentëve realizohet nëpërmjet sistemit</p>

<p>mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>PITAGORA të implementuar pranë FAB në Universitetin e Arteve. Studentët nepërmjet sistemit PITAGORA kane mundesine të shohin rezultatet e tyre ne librezen e notave; gjenerimin e vërtetimeve të ndryshme që mund të konsiderohen të nevojshme për studentët;</p> <p>Evidencë Nr. 4.18 Manuali Pitagora</p> <p>Evidencë Nr. 4.16 Screenshot nga sistemi Pitagora</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Duke marre ne konsideratë natyren specifike të programit por dhe të stafit akademike pjese e UA, personeli akademik ka një veprimtari akademike artistike e kerkimore mjaft të gjere. Ky proces verifikohet nepërmjet monitorimit të procesit mesimor të tyre, si dhe ne kuader të rezultateve përfundimtare të atelie; si dhe aspekti artistic shkencore kerimore i cili pasqyrohet nepërmjet dosjes personale të përditesuar dhe ne zyren e Burime Njerezore. Ne lidhje me aktivitete të tjera për të cilat stafi akademik ka nevojë për leje të veçantë, para fillimit të aktivitetit depozitohet në departament një kërkesë për leje, e cila nëse miratohet nga përgjegjësi i Njësisë Bazë, i përcillet Dekanit në përputhje me Rregulloren e FAB. Në përfundim të aktivitetit, stafi akademik ka detyrimin e dorëzimit të dokumentacionit justifikues dhe të një raporti.</p> <p>Evidenca Nr. 4.19 Fletëprezenca të pedagogëve në orën e mwsimit.</p> <p>Evidenca Nr. 4.20 Kërkësa e pedagogut për leje për krijimtari apo aktivitet</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>UA disponon faqe zyrtare WEB ku pasqyron një sere të dhenash që lidhur me programet e studimit, dhe çdo lloj aktiviteti kryer nga Departamentet e ndryshme apo stafi pjesemarres.</p> <p>Gjitashtu website përmban programet e çdo departamenti të ofruara ne UA me shpjegim dhe informacion me të gjere; duke pasqyruar dhe planet mesimore; ekspozitat te cilat kryehen nga Galeria FAB, Broshura Informuese; kontaktet e stafit akademike.</p> <p><i>Sygjerohet që në web e UA të figurojne stafi akademike i plotë i Departamentit të Artëve të Aplikuara duke bashkelidhur dhe një Bio të shkurtër, kjo për të treguar dhe nderlidhur një marrdhënie dhe me të gjere informative me publikun.</i></p>

	Web: http://uart.edu.al/index.php?pg=faq&id=28&niveli=47			
Konkluzione	<p><i>UA komunikon dhe menaxhon të dhena nëpërmjet websitit si dhe emaileve, por dhe nëpërmjet sistemit PITAGORA. Çdo student i programit Bachelor "Fotografi" disponon dosjen personale, me të dhenat personale dhe dokumentat e kerkuara për regjistrim. Duke marre ne konsideratë natyren specifike të programit por dhe të stafit akademike pjese e UART, personeli akademike vertët ka një veprimtari akademike artistike e kerkimore mjaft të gjere dhe cilesore. Ky proces verifikohet nëpërmjet monitorimit të procesit mesimore të tyre, si dhe ne kuader të rezultateve përfundimtare të atelie; si dhe aspekti artistic shkencore kerimore i cili pasqyrohet nëpërmjet dosjes personale të përditësuar dhe ne zyren e Burime Njëzore. UART disponon faqe zyrtare WEB ku pasqyron një sere të dhenash që lidhur me programet e studimit, dhe çdo lloj aktiviteti kryer nga Departamentet e ndryshme apo stafi akademike.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Ne lidhje me hartimin e një raporti financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit. Gjithashtu përpara fillimit të çdo viti akademik hartohet buxheti vjetor i programit bazuar në objektivat dhe programin mësimor të programit të studimit.</p> <p>Buxheti merr parasysh kërkesën dhe nevojën për burime njerëzore akademike dhe administrative në shërbim të programit, burime infrastrukturore, logjistike dhe didaktike si dhe investime afatgjata ku përfshihen pajisje për klasat, laboratore dhe investime të tjera. Buxheti gjithashtu parashikon burimet e financimit të kostove të përmendura mësipër.</p>

	<p>Evidenca Nr. 4.22 Paraqitja e buxhetit nga administratori i FAB</p> <p>Evidenca Nr. 4.23 VBA për miratimin e buxhetit</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Shpenzimet për burimet njerëzore, akademike dhe administrative që i shërbejnë programit vijojn me kërkes të paraqitur nga Njësia Bazë, përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Fotografi”.</p> <p>Për këtë program, Njësia Bazë mbulon financiarisht stafin akademik me kohë të plotë; ndërkaq stafi me kohë të pjesshme gjenerohet nga vetë të ardhurat e insitucionit. Gjitashtu përgjatë vizitës në lidhje me mbështjen për buxhet për shpenzimet lidhur me mjediset apo teknologjite e reja, merren në konsiderate. Për të siguruar një mbarrëvajtje të programit të studimit gjithmon në lidhje me financimin për stafin; përmisimin dhe kualitetin e mësimdhënies; mjediset; laboratorët; mjetet; sygjerohet të zhvillohen shkëmbime stafi me profile studimi të njëjtës trajtë studimi dhe pjesëmarrje në projekte Erasmus +; apo projekte të cilat do të mundësonin një vazhdimësi të sigurt për programin në koherencë me zhvillimet më të fundit në fushën e fotografisë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>UA nuk i është nënshtruar ndonjë auditimi financiar.</p> <p>Evidencë. Nr. 4.24. Pasqyrimi financiar vjetor i vitit 2023</p> <p>Evidencë. Nr.4.25 VKM Nr. 83, datë 03.02.2016</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Drejtorja e financave dhe bordi i administrimit janë njësitë të cilat miratojnë dhe shpërndajn grantet në UA. Për të diversifikuar burimet e të ardhurave për të rritur më tej të ardhurat dhe ne perpythje uljen e riskut nga rëniet e përkohshme të numrit të studentëve e cila po ndodh ne territory, sygjerohet të zhvillohen aktivitete nga departamenti të cilat gjenerojnë të ardhura si pjesëmarrja në projektet e financuara nga donatorë (EU), zhvillimi i konferencave dhe wokshopeve, kurset e trajnimit dhe kualifikimit si dhe</p>

	<p>aktivitete të tjera gjithmon në trajnën e specilaizimit të fushës së fotografisë; arteve pamore, etj.</p> <p>Evidenca Nr. 4.26 Të ardhura që parashikohen të realizohen nga Universiteti i Arteve Janar - Maj 2022</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Në vijim të qëndrueshmërisë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve; si dhe përgjatë takimeve me grupet përkatëse është parashtruar se për këtë program studimi (3 vite) nuk ka qënë nevoja për përmisimin e situatës financiare.</p> <p>Por duke marrë në konsiderate aspektin material të programit për vijueshmërinë e tij <i>nevoiten</i> mekanizma të caktuara për të gjeneruar burimet e nevojshme financiare të programit tre vite në avancë duke aplikuar për burime shtesë me projekte ndërkombëtare për të rritur kapacitetet e laboratoreve; apo mbështesi stafin akademik dhe kërkimin etj, si dhe të shihet mundësia për të vijuar me programin Master Shkencor në Artin e Aplikuar të Fotografisë; i cili mund të ofrojë qëndrueshmëri për këtë profil studimi si dhe për studentet.</p> <p>Evidencë Nr. 4.27 Rishpërndarja e të ardhurave dhe shtesa në regjistrin e prokurimeve</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Ne lidhje me hartimin e një raporti financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit Burimet e financimit të Njësisë Bazë vijnë në formë granti nga buxheti i shtetit, të ardhurat e krijuara nga institucioni dhe burime të tjera me destinacion. Për këtë program dhe për njësinë baze dhe FAB projekt buxheti afatmesem dhe ai i përvitshmi hartohet nga administrator i UA nepërmjet drejtorisë ekonomike. Planifikimi financiar nis çdo fillim viti kalendarik bazuar në ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, sikurse dhe në udhëzimet në varësi të tij.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

				X
--	--	--	--	----------

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>UA ka hartuar bazën e dokumenteve që orientojnë dhe mundësojnë realizimin e ciklit të plotë akademik për programin e studimit, nga hyrja deri në diplomim. Këto dokumente janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Statuti i UART (1.0.1) - Plani i zhvillimit strategjik 2018-2025 (1.0.7) - Rregullorja e UART (1.0.2) - Rregullorja e ciklit të parë të programeve Bachelor (1.0.3) - Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore në FAB (1.0.4) - Rregullorja e Departamentit të Arteve të Aplikuara (1.0.5) - Rregullorja e programit të studimit (1.0.6)
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në terren dhe takimeve të ndryshme të mbajtura, GVJ nuk vërejtë ndonjë shenjë diskriminimi, pabarazie ose sjelljeje që nuk i përkiste etikës akademike. U perceptua një ambient gjithëpërfshirës, harmonik, demokratik dhe respektues si ndër studentët ashtu edhe ndër stafin akademik.</p> <p>Parimet bazë të respektit reciprok dhe mos diskriminimit mbështeten edhe nga dokumentet kryesore dhe respektimi i tyre garantohej nga Këshilli i Etikës (6.10)</p> <p>Evidenca 6.10. Rregullore e funksionimit të Kodit të Etikës së UART.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e</p>	<p>Procesi i pranimit ndjek udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve të lëshuara për çdo vit akademik. GVJ vërejtë se informacioni mbi pranimin është i qartë dhe i aksesueshëm. Procesi i pranimit zhvillohet përmes konkursit. Kriteret e përzgjedhjes (5.0.2) janë publike në faqen web të universitetit.</p>

<p>studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>http://uart.edu.al/media/Rregulloret%20dhe%20kriteret%20BACHELOR,%202024-2025,%20FAB.pdf</p> <p>Referuar rregullores së programit të studimit (1.0.6) kriteret e pranimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në UART kandidatët për studentë i nënshtrohen konkurseve të pranimit për të gjitha programet e ciklit të parë që ofrohen. - Konkursi organizohet në zbatim të rregullores dhe kriterëve të miratuara në Senatin Akademik UART. - Çdo person (kandidat) që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm ka të drejtë të konkurrojë për t'u pranuar në këtë program studimi. - Konkursi për seleksionimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve të rinj, do të zhvillohet sipas kriterëve teknike të përcaktuara si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> a) Punë praktike (Fotografi) b) Testimi teorik c) Prezantimi i dosjes personale (Fotografi) - Studentët për të ndjekur këtë program studimi mund të pranohen nga Shqipëria, Kosova, Preshevë-Bujanovca, Maqedonia e Veriut, nga Mali i Zi dhe nga vende të tjera nëse kandidatët zotërojnë gjuhën shqipe dhe një gjuhë të huaj të certifikuar nga institucionet përgjegjëse. <p>Kuotat e miratuara nga Senati Akademik (2022-2023) për programin e studimit Bachelor në Fotografi përfshijnë edhe 1 kuotë për shtetas të huaj dhe 1 kuotë për studentë nga trojet (5.0.3)</p> <p>Evidenca 5.0.2. VSA nr 10 dt 02.02.2020 për miratimin e rregullores dhe kriterëve të konkurseve të pranimit për vitin akademik 2022-2023 për FAB;</p> <p>Evidenca 1.0.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Fotografi;</p> <p>Evidenca 5.0.3. VSA Nr_17, Dt_10_03_2022 Per deklarimin e kuotave te pranimit per vitin akademik 2022-2023.</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme</p>	<p>Në lidhjen e mësipërme paraqiten të detajuara procedurat e pranimit. Procedurat e transferimit apo njohjes së studimeve paraqiten në Manualin e transferimeve (5.0.1)</p> <p>Gjithashtu, në rregulloren e programeve Bachelor dhe atë të programit të studimit në Fotografi (1.0.3, 1.0.6) përcaktohen format e vlerësimit të dijeve dhe modalitetet e diplomimit.</p>

<p>ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Informacioni është i aksesueshëm online, si dhe pranë zyrave të universitetit. Duhet pasur parasysh se për shkak të numrit të vogël të studentëve, komunikimi i drejtpërdrejtë është i lehtë dhe efikas.</p> <p>Evidenca 5.0.1. Manuali i transferimeve;</p> <p>Evidenca 1.0.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Fotografi;</p> <p>Evidenca 1.0.3. Rregullore e Ciklit të parë të studimeve Bachelor.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Informacioni për studentët e mundshëm është lehtësisht i aksesueshëm në faqen e internetit të universitetit. Gjithashtu, të interesuarit mund të marrin informacion edhe përmes kontaktit direkt me zyrat që ndjekin regjistrimin e studentëve dhe në aktivitetet promovuese apo panairët e organizuara nga MAS ku UART merr pjesë. Pranimet bëhen sipas procedurës së mëposhtme të miratuar nga Senati Akademik (5.0.2) dhe të publikuar në web:</p> <p>http://uart.edu.al/media/Rregulloret%20dhe%20kriteret%20BACHELOR,%202024-2025,%20FAB.pdf</p> <p>Evidenca 5.0.2. VSA nr 10 dt 02.02.2020 për miratimin e rregulloreve dhe kriterëve të konkurseve të pranimit për vitin akademik 2022-2023 për FAB;</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>UA rezervon kuota të veçanta për kandidatët që i përkasin pakicave apo shtresave të marginalizuara. Konkretisht, në programin e studimit Bachelor në Fotografi (2022-2023) ka 1 kuotë të rezervuar për kandidatët e komunitetit Rom / Ballkano-egjiptian.</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Universiteti UA aplikon kriteret minimale të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për kandidatët nga shtetet e tjera. Këto kriteret janë të njëjta si për shtetasit shqiptarë (shih Kriterin 1, 3 dhe 5 të këtij Standardi). Në procedurat e publikuara nuk ka një përcaktim më vete për shtetasit e huaj.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit</p>	<p>UA trajton me bursa të pjesshme apo të plota studentë të këtyre kategorive:</p> <p><u>Studente ne nevojë</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Studentë familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike;

<p>në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Bashkëshortë me fëmijë që janë të dy studentë në IAL publike; - Studentë që rezultojnë persona me aftësi të kufizuara; - Studentë që kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuara; - Studentë që kanë një prind pensionist dhe prindi tjetër nuk jeton; - Studentë që i kanë të dy prindërit pensionistë; - Studentët, të tretët në radhën e fëmijëve e lart, të cilët vijnë nga familje me tre fëmijë e më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në IAL publike; - Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit deri në 25 vjeç; - Studentët që kanë humbur përgjegjësinë prindërore, me vendim gjykate të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç; - Studentët që janë identifikuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore deri në 25 vjeç; - Studentët që rezultojnë fëmijë të forcave të rendit të rënë në detyrë; - Studentët romë dhe egjiptianë; - Fëmijët e ish të dënuarve politikë; - Studentët me njërin prind me aftësi të kufizuar, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar; <p><u>bursa sipas merites</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Studentët e pranuar në vitin e parë me mesatare mbi 9 - Studentë në vitin e dytë ose të tretë me mesatare të studimeve mbi 9 <p>http://uart.edu.al/media/FORMULAR%20BURSA%20DHE%20PERJASHTIM%20CIKLI%20I.pdf</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Universiteti ofron një kornizë të plotë politikash, rregullash dhe dokumentacionesh që mbështesin të gjithë procesin akademik, nga pranimi deri në diplomim. Informacioni është lehtësisht i aksesueshëm përmes faqes së internetit të universitetit. Dokumentacioni bazë dhe procedurat janë të unifikuara në nivel institucional dhe garantojnë ecurinë e programit të studimit BSc në Fotografi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Rregulloret e përgjithshme dhe rregullorja e programit të studimit përshkruajnë me imtësi modalitetet e përparimit akademik:</p> <ul style="list-style-type: none">- Rregullorja e UART (1.0.2)- Rregullorja e ciklit të parë të programeve Bachelor (1.0.3)- Rregullorja e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore në FAB (1.0.4)- Rregullorja e Departamentit të Arteve të Aplikuara (1.0.5)- Rregullorja e programit të studimit (1.0.6) <p>Gjithashtu, në kontakt të vazhdueshëm me studentët është edhe personeli i departamentit dhe i programit të studimit, që informon studentët dhe trajton çështje specifike gjatë procesit mësimor. Studentët informohen për përparimin e tyre dhe kriteret dhe procedurat e vlerësimit përmes:</p> <ul style="list-style-type: none">• Informacionit të dhënë në klasë nga stafi pedagogjik;• Informacionit të ofruar përmes sekretarisë mësimore;• Informacioni i marrë në web dhe përmes sistemit PITAGORA;• Informacionit të dhënë në Departamentin e Arteve të Aplikuara; <p>Gjatë takimit me studentët, GVJ vërejti se studentët ishin të informuar mirë.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Transferimet dhe njohja e kualifikimeve të mëparshme kryhet duke u mbështetur në përcaktimet e rregullores së programit të studimit dhe Manualit të transferimeve (1.0.6, 5.0.1).</p> <p>Sipas këtij të fundit:</p> <ul style="list-style-type: none">- <i>Universiteti i Arteve pranon transferime të studentëve në vitet ndërmjetëse nga shkollat e tjera të larta, vendase ose të huaja, publike ose jopublike, dhe lejon transferimin e studentëve të tij në shkolla të tjera të larta, sipas procedurave të parashikuara në Statutin e tij, rregulloret përkatëse të secilit cikël studimi.</i>- <i>I interesuari paraqitet në Fakultetin përkatës ku dëshiron të transferojë studimet së bashku me dokumentacionin e</i>

	<p><i>përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për këtë procedurë. Pas verifikimit të dokumentacionit, bëhet protokollimi i tyre pranë sekretarisë së fakultetit. Aplikantit i jepet numri i protokollit. Transferimet lejohen brenda të njëjtit cikël studimi e në fusha të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. Njohja e krediteve të fituara nga studime të mëparshme të të njëjtit cikël studimi është e pakushtëzuar nga përafërsia e fushës së programit të studimit, me kusht që programet e lëndëve që njihen të jenë të njëjta ose të përafërta.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Sekretaria mësimore e kalon dokumentacionin për shqyrtim tek Përgjegjësi i Njesisë Bazë/Departamentit të fakultetit përkatës. Dekani i fakultetit ngre Komisionin e Njohjes dhe ekuivalentimit të lëndëve, në të cilën marrin pjesë përfaqësues të grup lëndëve që do të ekuivalentohen.</i> - <i>Dokumentacioni i kalon për shqyrtim komisionit i cili bën ekuivalentimin e programit që ka depozituar aplikanti me programin përkatës që kërkon të transferojë studimet, duke pasur parasysh kreditet e lëndës, programin e lëndës dhe notën e marrë.</i> <p>Evidenca 5.0.1. Manuali i transferimeve;</p> <p>Evidenca 1.0.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Fotografi.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Referuar rregullores së programit të studimit (1.0.6) Neni 11, format e kontrollit të dijeve janë: <i>bashkëbisedimet, kontrolltet teknike, mbrojtjet e punëve laboratorike, mbrojtje e detyrave e projekteve individuale dhe të kursit, mbrojtje e praktikave profesionale, provime të ndërmjetme, provimet e kursit, provimet e formimit, mbrojtje e temave e diplomave, aktivitetet artistike (ekspozita; workshop-e), etj.</i></p> <p>Sipas së njëjtës rregullore, Neni 16, <i>për të vlerësuar njohuritë, studenti që do të ndjekë programin e studimit Bachelor në "Fotografi", vlerësohet me notë. Për notat përdoret sistemi shqiptar i vlerësimit me 10 nota nga 1 tek 10, ku 10 është vlerësimi maksimal. Notat nga 5 (pesë) e lartë janë kaluese.</i></p> <p>Format specifike të vlerësimit përcaktohen në syllabusin e çdo lënde. Duke marrë në konsideratë numrin e vogël të studentëve dhe format e mësimdhënies në kontakti të vazhdueshëm me studentitn, rezulton se informacioni mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit transmetohet më së miri.</p> <p>Evidenca 1.0.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Fotografi.</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit (1.0.6) Neni 25 “Modalitetet e Diplomimit”, përcakton procedurën e diplomimit.</p> <p><i>Në përfundim të programit të studimit, studentët diplomohen në programin e studimit Bachelor në "Fotografi". Provimi i Diplomës mund të kryhet në një nga format e mëposhtme:</i></p> <p>a) <i>Mbrojtja artistike e diplomës;</i></p> <p>b) <i>Paraqitje e diplomës me tezë teorike;</i></p> <p>c) <i>Paraqitja e temës së diplomës me tezë teorike dhe mbrojtje artistike e diplomës;</i></p> <p>Evidenca 1.0.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Fotografi.</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Informacioni për të interesuarit aksesohet në disa mënyra. Informimi përmes faqes web dhe rrjeteve sociale është forma më e thjeshtë e komunikimit. Më konkretisht universiteti menaxhon:</p> <p>http://uart.edu.al/</p> <p>http://uart.edu.al/index.php?page=faqe&id=212&niveli=85</p> <p>https://www.facebook.com/groups/436866223177436/</p> <p>https://www.instagram.com/_uart/</p> <p>Një guidë e fakultetit mund të aksesohet online në:</p> <p>https://online.fliphtml5.com/bbpsc/tlxt/?fbclid=IwAR3J_D_KdKXKudqLMDs0UY38rtAJ4RyjLRKwkFr5muOz2fw5BL840-rjIEU</p> <p>Gjithashtu universiteti merr pjesë në panaiet e organizuara periodikisht nga MAS si dhe komunikon me publikun përmes eventeve artistike (3.13) të organizuara nga studentët dhe personeli akademik.</p> <p>Evidenca 3.13. Fletëpalosje me kalendarin e aktiviteteve të ndryshme të realizuara nga studentët dhe stafi akademik i FAB.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vërejt se informacioni për studentët është i disponueshëm dhe lehtësisht i aksesueshëm. Kjo u konfirmua gjithashtu nga vetë studentët, gjatë takimit të realizuar me ta. Sistemi i informacionit rezulton të jetë efikas duke marrë parasysh numrin e studentëve dhe format e mësimdhënies për programin specifik. Në përgjithësi mund të themi se komunikimi me studentët, edhe për shkak të natyrës specifike të programit, është i vazhdueshëm dhe i drejtpërdrejtë.</i></p>

Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>GVJ vërejtë se studentët janë të informuar mirë rreth strukturës, kohëzgjatjes dhe organizimit të programit. Ata marrin informacionin përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Takimeve formuese; - Personelit akademik; - Broshurave, guidave dhe fletëpalosjeve <p>https://online.fliphtml5.com/bbpsc/tlxt/?fbclid=IwAR3J_D_KdKXKudqLMDs0UY38rtAJ4RyjLRKwkFr5muOz2fw5BL840-rjIEU</p> <ul style="list-style-type: none"> - Sistemit PITAGORA; - Faqes web të universitetit; <p>Struktura dhe kohëzgjatja e programit të studimit është publike në:</p> <p>http://www.uart.edu.al/media/Plani%20M%C3%ABsimor%20Bsc%20Fotografi.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Përtej informacioneve të renditura në Kriterin 1 të Këtij Standardi, studentët informohen nga personeli akademik në fillim të vitit akademik, ku çdo profesor jep shpjegime dhe udhëzime të detajuara për lëndën e tij.</p> <p>GVJ vërejtë se studentët mund të aksesojnë informacionin mbi përbajtjen e kurseve. Ata marrin informacionin përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Faqes së internetit të dhe portalit PITAGORA; - Informacionit të ofruar në Departamentin e Arteve të Aplikuara.
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për</p>	<p>UA ka marrëveshje bashkëpunimi me institucionet kryesore të artit në Shqipëri (1.11). Gjithashtu, në kuadër të Paktit për Universitetin, UART ka nënshkruar një marrëveshje me Ministrinë e Kulturës (5.0.7), përmes së cilës palët angazhohen</p>

<p>orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>në bashkëpunim dhe ndihmë reciproke me synim realizimin e objektivave të Paktit.</p> <p>Në fakt, rezulton se një pjesë e studentëve të këtij programi, megjithëse ende të padiplomuar, janë përthithur nga tregu i punës në fushën e studimit apo disiplina të ngjashme. Në këtë kontekst, puna institucionale bëhet më e lehtë. GVJ vërejti se studentët janë të informuar mirë dhe janë në kontakt të vazhdueshëm me tregun e punës si përmes institucionit, ashtu edhe individualisht.</p> <p>Evidenca 1.11. Marrëveshje Bashkëpunimi të UART me institucione të tjera;</p> <p>Evidenca 5.0.7. Marrëveshja e UART me Ministrinë e Kulturës në kuadër të “Paktit për Universitetin”.</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Nga takimet e zhvilluara GVJ konstatoi se informacioni mbi procesin mësimor jepet vazhdimisht nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Burimet online dhe Sistemi PITAGORA; - Departamenti i Arteve të Aplikuara; - Sekretaria Mësimore; - Personeli Akademik. <p>Komunikimi rutinë realizohet përmes emaileve (4.15) apo përmes takimeve periodike.</p> <p>Evidenca 4.15. Screenshot nga komunikimi me email nga studentët dhe stafi akademik për programin Bsc. në Fotografji.</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Rezultatet e studenteve regjistrohen në librezën elektronike të sistemit PITAGORA. Përgjatë takimeve me stafin akademik, studentët si dhe sekretarinë mësimore rezultoi se informacioni ndërmjet personelit akademik dhe studentëve shkëmbehet nëpërmjet sistemit PITAGORA të implementuar pranë FAB në Universitetin e Arteve. Studentët nëpërmjet këtij sistemi kane mundësinë të shohin rezultatet e tyre në librezën e notave, të gjenerojnë vërtetime të ndryshme që mund të konsiderohen të nevojshme për studentët (4.18, 4.16).</p> <p>Evidenca 4.18. PITAGORA - Manuali i përdorimit për Sekretarinë Mesimore dhe studentet;</p> <p>Evidenca 4.16. Screenshot nga sistemi Pitagora.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se informacioni për studentët është i disponueshëm dhe lehtësisht i aksesueshëm. Sistemi i informacionit rezulton funksional duke marrë parasysh shkallën dhe numrin e studentëve për programin specifik. Gjatë takimit me studentët u konfirmua se, përtej informimit elektronik, ata janë në kontakt të vazhdueshëm me personelin</i></p>

	<i>akademik dhe me strukturat administrative mbështetëse për programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	GVJ konstatoi gjatë vizitës në universitet se sekretaria mësimore mbledh dhe ruan të dhëna të detajuara në lidhje me studentët dhe performancën e tyre. Ky program nuk ka ende të diplomuar.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Gjatë vizitës në UA, GVJ konstatoi se regjistrat e sekretarisë mësimore (themeltar, i arritjeve akademike dhe ai i dhënies së diplomave) janë të formatuar dhe të përditësuar sipas standardeve ligjore në fuqi. Pranë sekretarisë depozitohen edhe dokumentacioni i përgatitur nga personeli akademik lidhur me frekuentimin e studentëve dhe procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve. Programi i studimit ka pasur gjithsej 18 studentë të regjistruar (nga 6 cdo vit akademik) duke filluar nga viti akademik 2021-2022 dhe një transferim në vitin akademik 2022-2023. Në total janë 19 studentë (Tabela 21). Nuk raportohen largime. Këto të dhëna i referohen shtojcave të RVB si dhe ruhen në sekretarinë mësimore sipas formateve standarde të MAS dhe QSHA. Evidenca Tabela 21.
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe	Sekretaria mësimore ruan të dhënat (5.0.8) për të gjithë studentët. Kjo përfshin statusin, notat, frekuentimin, dhe informacionet e tjera të rëndësishme për avancimin e studentit. Pjesa e këtyre të dhënave është e dukshme për studentët përmes sistemit PITAGORA (4.18, 4.16), të mundësuar nga RASH, ndërsa të tjera janë të aksesueshme nga stafi i specializuar që mund të krijojë statistika ose analiza të të dhënave.

<p>lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ konstatoi gjatë vizitës se sekretaria mësimore gjithashtu ruan të dhënat zyrtare në letër, sipas formateve standarde të kërkuara.</p> <p>Evidenca 5.0.8. Foto me të dhëna nga sekretaria mbi studentët e Bsc. në Fotografi, bazuar në regjistrin themeltar dhe regjistrin e arritjeve akademike;</p> <p>Evidenca 4.18. PITAGORA - Manuali i përdorimit për Sekretarinë Mesimore dhe studentet;</p> <p>Evidenca 4.16. Screenshot nga sistemi Pitagora.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Përtej proceseve rutinë të punës, nuk u gjetën evidenca për auditim të mirëfillte të brendshëm të njësive përbërëse të universitetit dhe dokumentacionit të ruajtur në to. Duke qenë një program studimi me numër të vogël studentësh, sekretaria mësimore e ka më të lehtë ruajtjen e të dhënave dhe hartimin e dokumentacionit përkatës. Proceset e akreditimit të vazhdueshme përfshijnë gjithashtu kontrollimin e dokumentacionit të sekretarisë nga GVB dhe GVJ.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Departamenti harton raportin vjetor të punës së tij (1.0.8) duke trajtuar në mënyrë të përmbledhur çështjet kryesore në zhvillimin e mësimdhënies dhe aktivitetin kërkimor e artistik.</p> <p>Duke marrë parasysh numrin e vogël të studentëve, analizat mbi cilësinë e studentëve janë të thjeshta për t'u realizuar, por gjithashtu, ato nuk janë një tregues krahasimor. Sipas tabelës 21, mesatarja në hyrje në këtë program studimi varion nga 6.9-7.4. Mesatarja në dalje mbetet ende për t'u llogaritur në bazë të rezultateve pas diplomimit të brezit të parë.</p> <p>Evidenca 1.0.8. Raporti Vjetor i Departamentit të Arteve të Aplikuara 2022-2023.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vizitoi sekretarinë mësimore dhe shqyrtoi me hollësi dokumentacionin e vënë në dispozicion nga universiteti. Bazuar në sa më sipër konstatojmë se të dhënat ruhen si në formë të printuar ashtu edhe në formë digjitale. Të dhënat janë të detajuara dhe lehtësisht të aksesueshme. Universiteti</i></p>

	<i>prodhon raporte dhe analiza periodike bazuar në të dhënat e ruajtura.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Studentët përfaqësohen në organet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Senati Akademik (2/19 përfaqësues); http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=182&niveli=110 - Këshilli i Etikës (1/5 përfaqësues); http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=98&niveli=114 - Këshillin studentor (9/9); http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=136&niveli=88 - Komisioni i Sigurimit të brendshëm të Cilësisë (1 përfaqësues)(6.0.7); http://uart.edu.al/media/VSA%20Nr_%202024,%20dt_%2007_10_2021%20Mbi%20miratimin%20e%20Rregullores%20te%20Funksionimit%20te%20Njesise%20se%20Sigurimit%20te%20Brendshem%20te%20Cilesise,%20ne%20UART.PDF - Komisioni i marrëdhënieve me studentët (3/7 përfaqësues); http://uart.edu.al/media/VSA%20Nr_%202022,%20dt_%2007_10_2021%20Mbi%20miratimin%20e%20Rregullores%20te%20Funksionimit%20te%20Komisionit%20te%20Marredhenieve%20me%20Studentet%20ne%20UART.PDF
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin</p>	<p>Nga takimi me studentët rezultoi se ata janë të vetëdijshëm për përfaqësimin e tyre dhe e gjejnë deri diku efektive mënyrën si adresohen problemet dhe mendimet e tyre.</p> <p>Duhet theksuar se, duke qenë një universitet i vogël, është e lehtë që secili të dëgjohet. Universiteti rezultoi të jetë një</p>

<p>mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>komunitet gjithëpërfshirës dhe në të njëjtën kohë, komunikimi ndërmjet të gjithë aktorëve është relativisht i lehtë dhe efikas.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>Departamenti i Arteve të Aplikuara është në komunikim të vazhdueshëm me studentët përmes aktiviteteve mësimore. Sektori mësimor gjithashtu realizon sondazhe mbi programin e studimit me studentët dhe personelin akademik (5.10, 5.11).</p> <p>Duhet theksuar se, duke qenë një universitet i vogël, është e lehtë që secili të dëgjohet. Universiteti rezulton të jetë një komunitet gjithëpërfshirës dhe në të njëjtën kohë, komunikimi ndërmjet të gjithë aktorëve është relativisht i lehtë dhe efikas.</p> <p>Evidenca 5.10. Rezultatet e sondazhit të kryer nga Sektori Mësimor për studentët dhe stafin akademik;</p> <p>Evidenca 5.11. Raporti mbi pyetësorin e stafit të FAB, Gusht 2022.</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Referuar rregullores së programit të studimit (1.0.6), Neni 19, përcaktohen mënyrat e vlerësimit të studentit dhe mundësitë e ankimimit.</p> <p>Komunikimi i rezultateve bëhet në një seancë të posaçme ku studenti ka mundësi të njihet me vlerësimin dhe të shprehë mendimin e tij. Brenda 24 orëve nga marrja e rezultatit, studenti ka mundësi të ankohet për rezultatin. Në këto raste, Dekani verifikon rastin dhe jep edhe vlerësimin përfundimtar. Gjatë vizitës së GVJ, nuk u identifikua asnjë rast konkret ankimimi.</p> <p>Evidenca 1.06. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Fotografi.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstatoi se studentët janë të informuar mirë dhe të angazhuar në nivele të ndryshme si një pjesë e rëndësishme e universitetit dhe e programit specifik. Studentët janë të përfaqësuar drejtpërdrejt por edhe indirekt përmes kontaktit të vazhdueshëm me personelin akademik. Universiteti rezulton të jetë një komunitet gjithëpërfshirës dhe në të njëjtën kohë, për shkak të shkallës së vogël, komunikimi ndërmjet të gjithë aktorëve është relativisht i lehtë dhe efikas.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>Universiteti ka ngritur Sektorin Mësimor (5.0.9) ku përfshihen struktura e Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, të cilat janë përgjegjëse për informimin dhe asistencën e studentëve për aktivitetet e përditshme brenda universitetit. Gjithashtu, në kontakt të vazhdueshëm me studentët është edhe sekretaria mësimore (4.13), e cila asiston drejtpërdrejt procesin mësimor dhe administron dokumentacionin.</p> <p>Evidenca 5.09. Rregullore e Sektorit Mësimor dhe Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni;</p> <p>Evidenca 4.13. VSA Nr_ 23, dt_ 07_10_2021 Mbi miratimin e Rregullores te Funkionimit te Sekretarive Mesimore te Fakulteteve, ne UART.</p>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<p>Studentët janë në kontakt të vazhdueshëm me strukturën e universitetit dhe rezultojnë të jenë të informuar mirë dhe të kënaqur me nivelin e komunikimit dhe ndihmës. Ata marrin informacionin kryesor përmes internetit (web dhe social media) dhe sistemit PITAGORA, i cili u mundëson atyre të aksesojnë të dhëna dhe informacionet e rëndësishme për avancimin e tyre individual në program. Nga ana tjetër, Sekretaria Mësimore, Sektori Mësimor dhe Departamenti duket se janë efikasë dhe të dobishëm në procesin e informimit dhe këshillimit.</p>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia	<p>Sektori Mësimor, ku përfshihen struktura e Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, është përgjegjës për informimin dhe asistencën e studentëve për aktivitetet e përditshme brenda universitetit. Në rregulloren e tij thuhet (5.0.9):</p>

<p>për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p><i>Zyra mësimore, informimit të studentëve, karrierës dhe alumni. zbaton detyrat si më poshtë:</i></p> <p><i>Mban marrëdhënie të vazhdueshme me këshillat studentorë, drejton procesin e këshillimit të studentëve, mban komunikim me tregun e punës, si dhe ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve në fushën e arit dhe të kulturës.</i></p> <p><i>Përditëson bazën e të dhënave të institucioneve me të cilat UART ka marrëveshje bashkëpunimi, të cilat kanë në funksion Karrierën dhe punësimin e ardhshëm të të studentëve të UART.</i></p> <p>Në rastin e programit të studimit, një pjesë e studentëve fillojnë të lidhen me tregun e punës para diplomimit. Tregu i punës është ende i etur për profesionistë të rinj, kështu që në këtë rast, puna e zyrës së karrierës është disi më e lehtë.</p> <p>Evidenca 5.09. Rregullore e Sektorit Mësimor dhe Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni.</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Në rregulloren e Sektorit Mësimor (5.0.9) thuhet gjithashtu:</p> <p><i>Zyra mësimore, informimit të studentëve, karrierës dhe alumni ... zbaton detyrat si më poshtë:</i></p> <p><i>Ndjekjen dhe rritjen e marrëdhënieve të vazhdueshme me studentët aktualë dhe me studentët e diplomuar.</i></p> <p>Gjithashtu, UART është pjesë e projektit GRADUA ku përfshihen disa universitete vendase dhe ku synohet krijimi i një rrjeti ndëruniversitar profesionistësh.</p> <p><i>Projekti GRADUA do të mbështesë Universitetet Shqiptare duke implementuar një model të integruar të kërkesës bazuar në bazën e të dhënave të të diplomuarve nëpërmjet: mbledhjes së të dhënave për performancën e të diplomuarve; lehtësimin e bashkëpunimit midis IAL-ve dhe biznesit; lehtësimin e vendosjes së të diplomuarve në tregun e punës.</i></p> <p><i>Zbatimi i këtij projekti do të ndihmojë në organizimin e informacionit, duke mundësuar monitorim të vazhdueshëm dhe efektiv të sistemit të trajnimit dhe tregut të punës, ndërlidhjen dhe parashikimin e aftësive të nevojshme në të ardhmen për të përshtatur të diplomuarit në më të mirën e mundshme me tregun e punës. Projekti GRADUA mbështet Universitetet Shqiptare duke krijuar një model të përputhshmërisë së kërkesës bazuar në bazën e të dhënave të të diplomuarve (në modelin e zhvilluar në Itali) nëpërmjet:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - grumbullimit dhe analizimit të të dhënave për performancën e të diplomuarve dhe universiteteve, duke mundësuar

	<p><i>lëshimin e dokumentacionit të besueshëm, të vazhdueshëm dhe të përditësuar për vlerësimin e sistemit të arsimit të lartë në mbështetje të procesit të reformave në vazhdim;</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>lehtësimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë dhe botës së biznesit (shërbimet online të bazuara në TI janë zhvilluar dhe vënë në dispozicion të të diplomuarve, stafit universitar dhe kompanive);</i> - <i>lehtësimit të vendosjes së të diplomuarve në tregun e punës.</i> <p>http://www.artacademy.al/index.php?pg=faqe&id=845&niveli=84</p> <p>Sektori Mësimor disponon të dhëna për alumnit dhe statusin e tyre të punës. Në lidhje me programin e studimit Bachelor në Fotografi, nuk ka të dhëna pasi brezi i parë nuk ishte diplomuar ende në momentin e kryerjes së vizitës në universitet nga GVJ.</p> <p>Evidenca 5.09. Rregullore e Sektorit Mësimor dhe Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni.</p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstatoi se universiteti ofron strukturat e nevojshme për një ambient edukativ e funksional për studentët. Sektori Mësimor, Sekretaria Mësimore, së bashku me strukturat e departamentit, ofrojnë mbështetje të vazhdueshme për studentët e programit. Mbështetur edhe në takimin e realizuar me studentët, rezulton se ndërveprimi i tyre me këto struktura është i vazhdueshëm dhe funksional.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel	GVJ identifikoi për zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies Manualin e Përdorimit të Microsoft Teams

<p>institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>(6.0.1) i cili ka shërbyer kryesisht gjatë periudhës së pandemisë COVID 19.</p> <p><i>Megjithëse nuk identifikohen metoda të veçanta të lidhura drejtpërdrejtë me karakterin e programit në Fotografî, ky udhëzues konsiderohen si element pozitiv në cilësinë e mësimdhënies. Është për t'u përmendur se në përgjithësi, në UA, mësimdhënia eksploron metoda jo tradicionale, përmes punës krijuese dhe projekteve e konsultimeve individuale.</i></p> <p>Evidenca 6.01. Manuali i përdorimit të sistemit Microsoft Teams.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Përtej punës rutinë të Departamentit dhe Fakultetit, Sektori Mësimor monitoron dhe vlerëson personelin akademik në aktivitetin e mësimdhënies. Kjo strukturë funksionon në bazë të rregullores përkatëse (5.0.9). Për vlerësimin e mësimdhënies aplikohen sondazhet me studentët dhe personelin akademik (5.10, 5.11, 6.0.2, 6.03) si dhe raportimi periodik mbi punën e kryer (1.08, 3.0.4, 6.05).</p> <p>Evidenca 5.0.9. Rregullore e Sektorit Mësimor dhe Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni;</p> <p>Evidenca 5.10. Rezultatet e sondazhit të kryer nga Sektori Mësimor për studentët dhe stafin akademik;</p> <p>Evidenca 5.11. Raporti mbi pyetëtorin e stafit të FAB, Gusht 2022;</p> <p>Evidenca 6.0.2. Pyetësor për stafin akademik;</p> <p>Evidenca 6.0.3. Pyetësor për studentët;</p> <p>Evidenca 1.0.8. Raporti Vjetor i Departamentit të Arteve të Aplikuara 2022-2023;</p> <p>Evidenca 3.0.4. Raporti vjetor i punës artistike mësimore shkencore e stafit akademik për vitin akademik 2021-2022;</p> <p>Evidenca 6.0.5. Raporti vjetor i Departamentit për tre vitet e fundit për analizën për procesin mësimor, rezultatet e vlerësimit dhe adresimin e mangësive.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve,</p>	<p>Studentët japin vlerësim periodik për proceset akademike përmes sondazhit të studentëve (6.0.3). Mbi rezultatet hartohet edhe një raport përmbledhës, i cili më pas adreson edhe gjetjet e sondazhit (5.10). Referuar rregullores së programit të studimit (1.0.6), Neni 19, (shih edhe Standardi V.5, Kriteri 4) studentët kanë të drejtë të ankimohen.</p> <p>Nga GVJ nuk u konstatuan raste ankimesh gjatë takimit me studentë. Përmasat e vogla të programit të studimit mundësojnë</p>

përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	një komunikim mjaft të mirë mes personelit akademik dhe studentëve, gjë që eviton dukshëm mekanizmin e ankimit. Evidenca 6.0.3. Pyetësor për studentët; Evidenca 5.10. Rezultatet e sondazhit të kryer nga Sektori Mësimor për studentët dhe stafin akademik; Evidenca 1.0.6. Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në Fotografi.			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Rezultatet e vlerësimit apo raportet analitike përkatëse (5.10) nuk rezultojnë të aksesueshme dhe publike. <i>Rekomandohet</i> bëri publike e rezultateve duke shfaqur analiza të përgjithshme e duke shmangur informacione apo të dhëna që lidhen me individë.			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Sondazhet dhe raportet përkatëse analizohen dhe diskutohen nga autoritetet drejtuese dhe personeli akademik duke evidentuar problematikat apo edhe praktikave të mira. Ky proces ndikon në nxitjen e personelit akademik dhe strukturave në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Ky angazhim u vu re edhe gjatë takimit të GVJ me personelin akademik. Evidenca 5.10. Rezultatet e sondazhit të kryer nga Sektori Mësimor për studentët dhe stafin akademik.			
Konkluzione	<i>Gjatë vizitës në universitet dhe vlerësimit të dokumentacionit, GVJ vërejt një përpjekje të strukturuar dhe të vazhdueshme në përmirësimin dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Studentët gjithashtu janë të përfshirë dhe aktorë të rëndësishëm në procesin e vlerësimit. U konstatua se rezultatet e vlerësimeve nuk bëhen publike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Nga njohja e GVJ me institucionin tre rezultojnë strukturat kryesore në UART që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Departamenti (1.0.5) - Sektori Mësimor (5.0.9) - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (6.0.7) <p>Sipas rregullores së funksionimit të NJSBC, struktura përgjegjëse është Zyra Mësimore dhe Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Karrierës dhe Alumnit. Kjo zyrë kryen vlerësimin dhe raportimin periodik në përputhje me standardet e cilësisë. Kjo zyrë raporton tek Zv. Rektori për anën mësimore.</p> <p>http://uart.edu.al/media/VSA%20Nr_%202024,%20dt_%2007_10_2021%20Mbi%20miratimin%20e%20Rregullores%20te%20Funksionimit%20te%20Njesise%20se%20Sigurimit%20te%20Brendshem%20te%20Cilesise,%20ne%20UART.PDF</p> <p>Evidenca 1.0.5. Rregullore e Departamentit të Arteve të Aplikuara;</p> <p>Evidenca 5.0.9. Rregullore e Sektorit Mësimor dhe Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni;</p> <p>Evidenca 6.0.7. Urdhëri i Rektorit për ngritjen e Komisionit Ad Hoc të Njësive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Plani i Zhvillimit strategjik në UART (2017-2025) i kushton një kapitull të veçantë Sigurimit të cilësisë (1.0.7 Kreu 5). Strategjia e Zhvillimit të universitetit (1.0.7) dhe akreditimet periodike janë dokumente dhe procese të rëndësishme që mbajnë aktive sistemin e Sigurimit të Cilësisë. Duke iu referuar Rregullores së Funksionimit të NJSBC, Neni 5, përbërja e Komisionit është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Një specialist i SC në UART; - Një përfaqësues për secilin Fakultet; - Një përfaqësues i Studentëve; <p>Në rastet kur ka akreditime për herë të parë apo institucionale, thirret një ekspert i jashtëm.</p> <p><i>Nga sa vihet re, ky komision nuk ka përfaqësues të përhershëm të Alumni apo ekspertë të jashtëm të cilët do të mund të sillnin një perspektivë përtej rutinës institucionale. GVJ vlerëson se angazhimi i tyre edhe përtej proceseve të akreditimit do të sillte një kontribut të vazhduar dhe pozitiv.</i></p>

	Evidenca 1.0.5. VBA Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025.
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Universiteti është subjekt i akreditimeve periodike institucionale dhe programore, një praktikë e vendosur prej disa vitesh. Raportet e vlerësimit të brendshëm hartohen si pjesë e procedurës standarde, pasuar nga raportet e vlerësimit të jashtëm.</p> <p>Rezultatet e akreditimeve tregojnë se universiteti ka një performancë të qëndrueshme në lidhje me cilësinë e programeve, që dëshmon masa dhe mjete efikase për Sigurimin e Cilësisë.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Performanca e stafit vlerësohet përmes deklaratimit dhe treguesve të matshëm të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Format i raportimit të punës vjetore (4.0.4) përmban këta tregues:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Orë mësimdhënie në auditor; - Orë praktike mësimore; - Orë Konsultime; - Orë Udhëheqje Diplome; - Orë hartim Recencas; - Orë provime / kolokiume; - Orë përgatitje individuale; - Orë ekspozita / shfaqje; - Orë kërkimi / veprimtari krijuese; - Orë pjesëmarrje në borde shkencore; - Kontribut institucional; - Kontribut profesional; - Të tjera <p>Në bazë të realizimit llogaritet edhe mbingarkesa e cila shpërblehet sipas legjislacionit në fuqi për IAL publike. Ndërkohë, përmes departamentit dhe strukturave të tjera të universitetit nxitet dhe promovohet përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së syllabuseve, planit mësimor dhe mësimdhënies në tërësi.</p> <p>Evidenca 4.0.4. Realizimi i marrëveshjeve vjetore, Njësia Bazë.</p>

Konkluzione	<i>Politikat dhe procedurat në lidhje me Sigurimin e Cilësisë janë prezente dhe në proces konsolidimi. Të tilla praktika janë integruar në punën e përditshme të stafit akademik dhe ndihmojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të programit. Me zhvillimin e mëtejshëm të programit do të nevojitet edhe hartimi i qasjeve specifike të lidhura me natyrën e programit dhe perspektivën e tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Sigurimi i cilësisë së programit është përgjegjësi e Departamentit të Arteve të Aplikuara. Departamenti monitoron aktivitetin e përditshëm, kryen analiza periodike dhe iniciativat për ndryshime dhe përmirësime në strukturën dhe përmbajtjen e programit. Analiza e punës vjetore të departamentit dokumentohet përmes raporteve të departamentit (1.0.8, 6.0.5).</p> <p>Departamenti dhe Sektori Mësimor zhvillojnë gjithashtu një analizë të sondazheve periodike mbi mësimdhënien (6.0.2, 6.0.3, 3.0.6, 5.11).</p> <p>Evidenca 1.0.8. Raporti Vjetor i Departamentit të Arteve të Aplikuara 2022-2023;</p> <p>Evidenca 6.0.5. Raporti vjetor i Departamentit për tre vitet e fundit për analizën për procesin mësimor, rezultatet e vlerësimit dhe adresimin e mangësive;</p> <p>Evidenca 6.0.2. Pyetësor për stafin akademik;</p> <p>Evidenca 6.0.3. Pyetësor për studentët;</p> <p>Evidenca 3.0.6. Të dhëna nga pyetësori i studentëve të programit Bsc. në Fotografi;</p> <p>Evidenca 5.11. Raporti mbi pyetësorin e stafit të FAB, Gusht 2022.</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të</p>	<p>Në bazë të vlerësimit të pyetësorëve, raportet me të dhënat dhe informacionet (3.0.6, 5.11) shqyrtohen në Njësinë Bazë dhe në</p>

<p>përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Rektorat. Gjithashtu, si një detyrë nga proceset e akreditimit, universiteti adreson rekomandimet e bordit të akreditimit. Analiza Vjetore e Departamentit (6.0.5) adreson çështje si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaria mësimore; • Ngarkesa mësimore; • Procesi i vlerësimit të brendshëm; • Infrastruktura për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor; • Aktivitetet e realizuara; • Galeria FAB; • Të tjera. <p>Megjithëse dokumentacioni ekziston, analiza e thelluar dhe ndjekja e problematikave (rezultatet e pritura, motivimi i praktikave më të mira dhe arritjet etj.) kryhet në punën e përditshme të departamentit dhe jo përmes proceseve të dokumentuara.</p> <p>Evidenca 3.0.6. Të dhëna nga pyetësi i studentëve të programit Bsc. në Fotografi;</p> <p>Evidenca 5.11. Raporti mbi pyetësin e stafit të FAB, Gusht 2022;</p> <p>Evidenca 6.0.5. Raporti vjetor i Departamentit për tre vitet e fundit për analizën për procesin mësimor, rezultatet e vlerësimit dhe adresimin e mangësive.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të siguruar dhe takimeve me studentët dhe stafin akademik, GVJ vërejti se metoda të drejtpërdrejta të vlerësimit janë të aplikuara për të verifikuar përparimin e studentëve dhe performancën e tyre. Këto metoda përfshijnë provimet, detyra, projekte, performanca dhe aktivitete artistike, teste dhe kuize, vlerësimin e punës në grupe, detyra, frekuentimin dhe pjesëmarrjen etj. Duke pasur parasysh natyrën e veçantë të mësimdhënies në disipinat e artit, në lëndët profesionale, vlerësimi bëhet mbi punën / projektet që janë specifike për disipinën e fotografisë (2.0.6, 3.13, 3.15, 6.06). Këto janë të gjitha elemente që janë vlerësuar kryesisht nga stafi akademik. Një pjesë e punës së kryer është e hapur edhe ndaj vlerësimit publik (ndonëse jo zyrtar) në ekspozita dhe aktivitete artistike.</p> <p>Evidenca 2.0.6. Projektet artistike të programit të studimit Bsc në Fotografi;</p> <p>Evidenca 3.13. Fletëpalosje me kalendarin e aktiviteteve të ndryshme të realizuara nga studentët dhe stafi akademik i FAB;</p>

shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Evidenca 3.15. Projekte artistike të studentëve të programit Bsc në Fotografi, të mbështetura nga Departamenti.			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	Metodat indirekte të vlerësimit (kryesisht pyetëtorët dhe analizat e të dhënave) përdoren për të marrë të dhëna dhe perceptime që mund të ndihmojnë në sigurimin e cilësisë së përgjithshme të programit (6.03, 6.02). Këto analiza dhe të dhëna ndihmojnë në identifikimin e problemeve dhe mundësive për përmirësim, bazuar në perceptimet e aktorëve të ndryshëm ose në të dhënat e siguruar nga indikatorë të matshëm. Një tjetër mënyrë e vlerësimeve indirekte është feedback-u që merret gjatë aktiviteteve artistike, ekspozitave, performancave apo projekteve të bashkëpunimit me institucionet e ndryshme kulturore (2.0.6, 3.13, 3.15, 6.06). Ekspozimi i punës së studentëve ndaj një komuniteti më të gjerë se ai akademik është një praktikë e mirë dhe e domosdoshme për natyrën e programit të studimit. Evidenca 6.0.2. Pyetësor për stafin akademik; Evidenca 6.0.3. Pyetësor për studentët; Evidenca 2.0.6. Projektet artistike të programit të studimit Bsc në Fotografi; Evidenca 3.13. Fletëpalosje me kalendarin e aktiviteteve të ndryshme të realizuara nga studentët dhe stafi akademik i FAB; Evidenca 3.15. Projekte artistike të studentëve të programit Bsc në Fotografi, të mbështetura nga Departamenti.			
Konkluzione	<i>GVJ vërejtë se departamenti dhe strukturat e universitetit të lidhura me Sigurimin e Cilësisë, kryejnë një përpjekje të vazhdueshme për të monitoruar dhe kontrolluar cilësinë e programit. Instrumentat dhe praktikat e përdorura janë duke u konsoliduar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Duke iu referuar Rregullores së Funkzionimit të NJSBC, Neni 5, përbërja e Komisionit është:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Një specialist i SC në UART; - Një përfaqësues për secilin Fakultet; - Një përfaqësues i Studentëve; <p>Në rastet kur ka akreditime për herë të parë apo institucionale, thirret një ekspert i jashtëm.</p> <p>http://uart.edu.al/media/VSA%20Nr_%202024,%20dt_%2007_10_2021%20Mbi%20miratimin%20e%20Rregullores%20te%20Funkzionimit%20te%20Njesise%20se%20Sigurimit%20te%20Brendshem%20te%20Cilesise,%20ne%20UART.PDF</p> <p>Gjithashtu, angazhimi i pedagogëve të jashtëm, të lidhur drejtpërdrejt me tregun e punës jep një feedback të vazhdueshëm për politikat dhe qasjet e institucionit në drejtimin e SBC.</p> <p><i>Përfshirja e një eksperti të jashtëm si pjesë e përhershme e NJSBC do të mund të sillnin një perspektivë përtej rutinës institucionale.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Referuar të njëjtës rregullore (shih më sipër), Neni 6, NJSBC ka këto detyra.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbledh të dhënat sipas treguesve sasiorë dhe cilësorë për institucionin dhe programin e studimit; - Organizon vlerësimin e vazhdueshëm periodik të SC; - Krijon një sistem dokumentacioni për SC, duke përditësuar procedurat e ndryshme; - Përmirëson metodologjinë e punës për arritjen e qëllimeve dhe objektivave; - Bën vlerësimin për stafin akademik; - Bën përpunimin e pyetësorëve; - Nxit pjesëmarrjen dhe angazhimin për zbatimin e rekomandimeve përmes plan-veprimeve; - Bashkërendon dhe asiston procesin e vlerësimit të brendshëm; - Merr pjesë në GVB; - Ruan dhe përmirëson njohuritë teknike përmes trajnimeve; - Harton çdo 2 vite RVB në nivel institucional; - Etj. <p>GVJ konstatoi se këto procese kryhen nga NJSBC, edhe pse një pjesë e tyre nuk janë gjithmonë të dokumentuara përmes raporteve dhe evidencave. Gjithsesi, praktikat vlerësohen të</p>

	vendosura dhe në proces konsolidimi. Përtej NJSBC, Departamenti dhe Sektori mësimor kanë peshën dhe detyrat kryesore në rutinën e mbarëvajtjes dhe SC për programin e studimit.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Raporti i vlerësimit të brendshëm, pjesë e vlerësimit të cilësisë së programit, është përgatitur nga një grup i përbërë nga 5 persona që përfaqësojnë Departamentin e Arteve të Aplikuara, administratën e universitetit dhe studentët. Të gjithë anëtarët e grupit kanë marrë pjesë në mbledhjen e të dhënave, analizën dhe hartimin e raportit, sipas pozicionit dhe kompetencave të tyre. Angazhimi i aktorëve dhe palëve të interesuara është ilustruar gjithashtu në Kriterin 1 të këtij standardi.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Gjatë vizitës në universitet dhe takimeve të ndryshme që u mbajtën, GVJ konstatoi mungesën e çdo shenje diskriminimi, pabarazie apo sjelljeje që nuk i përket etikës akademike. Një ambient gjithëpërfshirës, harmonik dhe respektues u perceptua si ndër studentët ashtu edhe ndër stafin akademik.
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk kemi evidencë për angazhimin e drejtpërdrejtë të ekspertëve të jashtëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Siç përmendet më sipër, referuar rregullores së NJSBC në rastet kur ka akreditime për herë të parë apo institucionale, thirret një ekspert i jashtëm. Gjithashtu, angazhimi i pedagogëve të jashtëm, të lidhur drejtpërdrejt me tregun e punës jep një feedback të vazhdueshëm për politikën dhe qasjet e institucionit në drejtimin e SBC. Po ashtu përmes kontakteve me universitete të huaja mundësohet shkëmbimi i eksperiencave të mira dhe marrja e feedback-ut. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm si pjesë e përhershme dhe zyrtare e strukturave të SBC do të mund të sillnin një perspektivë përtej rutinës institucionale.
Konkluzione	<i>GVJ ka konstatuar një ambient ku palët e përfshira në procesin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ndërveprojnë pa</i>

	<i>diskriminim apo pabarazi mes tyre. Përtej aktorëve të universitetit, nevojitet angazhimi më aktiv i Alumni, ekspertëve të jashtëm dhe përfaqësuesit e tregut të punës në strukturat e SBC si dhe në procese të ndryshme që janë të lidhura me rolin e tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Në përgjithësi, GVJ konstatoi një nivel transparence dhe komunikimi të mirë brenda universitetit. Një pjesë e mirë e dokumentacionit, rregulloreve dhe informacionit aksesohet lehtësisht online përmes faqes web. UA përdor faqen zyrtare të web- it dhe rrjetet sociale, komunikimin me email dhe takimet informuese në kuadër të këtij qëllimi. http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=211&niveli=73 http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=6&niveli=25
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Duke qenë se ky është një akreditim për herë të parë i programit të studimit GVJ nuk arriti të gjejë informacione publike mbi rezultatet e vlerësimeve periodike. RVB / RVJ për programet e tjera të studimit dhe rezultatet e vlerësimeve apo raportet analitike përkatëse (5.10) nuk rezultojnë të aksesueshme dhe publike. <i>Në vijim të akreditimit, rekomandohet bërja publike e raporteve të hartuara për këtë program (përfshirë këtë RVJ) dhe rezultateve të pyetësorve, duke shfaqur analiza të përgjithshme e duke shmangur informacione apo të dhëna që lidhen me individë.</i> Evidenca 5.10. Rezultatet e sondazhit të kryer nga Sektori Mësimor për studentët dhe stafin akademik.
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të	Në RVB deklarohet se çdo raport vjetor, sondazh etj. shoqërohet me një plan masash. Megjithëse u vërejt funksionimi i plotë i

shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	strukturave, institucioni nuk ka paraqitur evidenca për plane veprimi konkrete dhe implementimin e tyre. Duke marrë parasysh që ky është një akreditim për herë të parë i programit të studimit, pritet që në përfundim të procesit të hartohet një plan veprimi mbi rekomandimet e Bordit të Akreditimit. Plane të ngjashme inkurajohet të hartohen edhe për analizat e brendshme.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Duhet theksuar se sistemi i Sigurimit të Cilësisë në UA është i ngritur në aspektin formal dhe është relativisht i konsoliduar. Departamenti menaxhon dhe monitoron ecurinë e programit të studimit dhe kryen punë të vazhdueshme në zhvillimin e tij. Procesi i parë i akreditimit (hartimi i RVB dhe RVJ) është në thelb hapi fillestar në vlerësimin e gjithanshëm të këtij programi, i cili deri tani rezulton të jetë integruar mjaft mirë në ofertën akademike të UA.
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	<p>Aktivitetet e zhvilluara për SBC të programit të studimit janë pjesë e rutinës akademike dhe administrative të institucionit. Këto aktivite përfshijnë mbledhjet e departamentit (2.0.3), takimet koordinuese për akreditimin, zhvillimin e pyetësorëve (3.0.6, 5.11), analizat vjetore (1.0.8, 3.0.4, 6.0.5) etj.</p> <p>GVJ nxit që këto veprimtari të shtrihen përtej praktikave rutinë, me qëllim konsolidimin e mëtejshëm të sistemit të SBC tek personeli akademik dhe studentët.</p> <p>Evidenca 2.0.3. Procesverbal i një mbledhjeje të Departamentit;</p> <p>Evidenca 3.0.6. Të dhëna nga pyetësi i studentëve të programit Bsc. në Fotografi;</p> <p>Evidenca 5.11. Raporti mbi pyetësorin e stafit të FAB, Gusht 2022;</p> <p>Evidenca 1.0.8. Raporti Vjetor i Departamentit të Arteve të Aplikuara 2022-2023;</p> <p>Evidenca 3.0.4. Raporti vjetor i punës artistike mësimore shkencore e stafit akademik për vitin akademik 2021-2022;</p> <p>Evidenca 6.0.5. Raporti vjetor i Departamentit për tre vitet e fundit për analizën për procesin mësimor, rezultatet e vlerësimit dhe adresimin e mangësive.</p>
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se informacioni i lidhur me Sigurimin e Cilësisë është i disponueshëm dhe se programi i studimit është inkadruar në sistemin e SBC të universitetit. Informacioni kryesor mbi institucionin, dokumentet bazë dhe programin e studimit mund të aksesohet përmes faqes web të universitetit. Sondazhet periodike</i>

	<i>të realizuara shqyrtohen dhe analizohen në nivel njësie bazë dhe institucioni. Rezultatet e tyre dokumentohen në raportet periodike. Përtej kuadrit të përgjithshëm, vihet re që në programe me këto përmasa dhe specifika, puna efektive për SBC realizohet në përditshmërinë e funksionimit të njësisë bazë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Fotografi.”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Program studimor unik në vend, që promovon traditën e Fotografisë Shqiptare në vend dhe rajon; me potencial për t’u zhvilluar më tej, duke e trajtuar Fotografinë si profesion;
2. Bashkëpunimet me institucione kulturore, arsimore, apo sektorë të caktuar të tregut të punës;
3. Kualifikimet artistike të stafit akademik në FAB, si dhe veprimtaria e tyre artistike në fushën e Arteve Pamore dhe Fotografisë;
4. Historiku dhe tradita e Universitetit të Arteve si institucion lider në fushën e artit dhe formimin artistik të brezave;

b. Pika të dobëta:

1. Mungesa e një programi Master i Shkencave në Fotografi, mundësi për studentët e programit bachelor për të vijuar me studimet e tyre; **(Standardi II.3 / Kriteri 5)**
2. Përqindja totale e lëndëve A dhe B nuk është në përputhje me VKM nr. 41, datë 24. 01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”; **(Standardi II.4 / Kriteri 4)**
3. Rezultatet dhe analizat e anketimeve periodike mbi cilësinë e mësimdhënies nuk janë publike; **(Standardi VI.1 / Kriteri 4, Standardi VI.5 / Kriteri 2)**

Rekomandime:

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

1. Në kuadër të marrëveshjeve Erasmus+ të zhvillohen projekte dhe mobilitete të studentëve të programit "Bachelor Fotografi" me Universitetin përkatës, apo të krijohen marrëveshje të reja të cilat i përkasin të njëjtës fushë studimi;
2. Mbështetje në buxhet për materialet laboratorike përkatëse si dhe zgjerimi i laboratorëve si për fotografinë analoge apo atë dixhitale, përditësimi i aparaturave për programin e studimit në kuadër të mbarëvajtjes dhe të cilësisë së programit;
3. Të rishikohen ndarja në përqindje e krediteve për lëndët të kategorisë A dhe B. Përqindja totale e lëndëve A dhe B nuk duhet të jetë më pak se 70 %, duhet rishikuar ndarja e veprimtarive formuese në planin mësimor, në përputhshmëri me VKM nr. 41, datë 24. 01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë";
4. Rezultatet e vlerësimeve dhe anketimeve periodike të formave dhe metodave të mësimdhënies duhet të bëhen publike;
5. Të shtohen përpjekjet për kualifikimin dhe fitimin e titujve akademikë në fushën artistike dhe kërkimore për stafin akademik të UART;

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Photography."

a. Strengths and affirmations;

1. Unique study program in the country, promoting the tradition of Albanian Photography to the country and region; potential to develop further the profession and art of Photography to the locality and region, treating Photography as a profession;
2. Collaborations with cultural, educational institutions, or certain sectors of the labour market;
3. The artistic qualifications of the academic staff at FAB, as well as their artistic activity in the field of Visual Arts and Photography;
4. The history and tradition of the University of Arts as a leading institution in the field of art and the artistic education of generations;

b. Weaknesses;

1. Lack of a Master of Science program in Photography, missed opportunity for the enrolled student in the bachelor program to deepen more their studies; *(Standard II.3 / Criterion 5)*
2. The total percentage of subjects A and B is not in accordance with VKM no. 41, date 24. 01.2018 "On the elements of study programs offered by higher education institutions"; *(Standard II.4 / Criterion 4)*
3. The results and analysis of periodic surveys on the quality of teaching are not public; *(Standard VI.1 / Criterion 4, Standard VI.5 / Criterion 2)*

Recommendation

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

1. In the framework of the Erasmus+ agreements, projects and mobility of students of the "Bachelor Photography" program with the relevant University should be developed, or new agreements should be created which belong to the same field of study;
2. Support in the budget for relevant laboratory materials as well as the expansion of laboratories for analog or digital photography, the updating of equipment for the study program within the framework of the completion and quality of the program;
3. Review the percentage allocation of credits for subjects of category A and B. The total percentage of subjects A and B should not be less than 70%, the division of formative activities in the curriculum should be reviewed, in accordance with VKM no. 41, date 24. 01.2018 "On the elements of study programs offered by higher education institutions";
4. The results of periodic evaluations and surveys regarding teaching methods and forms should be made public;
5. Increase efforts to qualify and obtain academic titles in the artistic and research fields for UART academic staff;

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X